

Mehmet Elxhi

BIBLIOTEKA

8SH-992

E 54

AJO
QE MIE
NDJIEK
PAS

85H-992
E 54

MEHMET
ELEZI

AJO
QË MË
NDJEK
PAS



SHTËPIA BOTUESE
«NAIM FRASHËRI»

Redaktor

QEMAL SAKAJEVA

Kopertina

IBRAHIM ÇEZMA

Reconsues

Remzi Lani

Ajo që më ndjek pas

Për një çast të duket sikur dallgët e Mesdheut u derdhën me shkulme të çmendura drejt bregut, por, duke u ndeshur me afshin e ngrohtë që vinte nga Sahara e me pamjen e verdhë të shkretëtirës, u hutuan e shtangën në vend nga habia. Mbi këto dallgë, që ngrinë e u ngurtësuan, duke u shndërruar në kodra plot jetë, ngrihet Algjeri. Kasbane e tij, lagje karakteristike, me rrugët aq të ngushta, saqë mund të këmbesh cigaret, madje dhe filxhanët e kafes, nga dy dritare përballë, pothuajse e kemi të njohur nëpër-

mjet skenave të «Betejës së Algjerit» dhe nga reportazhet e botuara në shtyp. Por Algjeri është një qytet i madh e i bukur, me shtëpitë e reja të banimit e rrugët e ndriçuara, me komplekset sportive e parqet plot gjelbërim, që rrinë nën hijen e monumentit të dëshmorëve, ngritur në një pikë mbizotëruese. Omari na thotë që është 92 m i lartë. Në këmbët e tij, plotësisht i harmonizuar, shtrihet Muzeu Historik.

— Na sollët mbarësinë, — thotë koleg Burkezaza, Sekretar i Përgjithshëm i Bashkimit Kombëtar të Rinisë Algjeriane.

Ka parasysh shiun e butë që bie, retë bojëhiri të varura mbi det me një mendim premtues. Prej kohësh edhe këtu ka marrë thatë.

— Doemos, i them. Tok me shiun, sollëm njëkohësisht pranverën e lulëzimin. — Dhe i tregoj me dorë dy shokët e tjerë të delegacionit që quhen pikërisht Pranverë e Lulëzim.

Qeshim sikur njihemi prej kohësh. Të dyja palët parapëlqejmë këtë hyrje aspak zyrtare, e cila pasohet me një dialog krejt shoqëror, çka nuk ndodh zakonisht në ato raste kur biseda fillon me shiun e me kohën në përgjithësi.

Pak para nesh ka ardhur skuadra e volejbollit e «17 Nëntorit» për të zhvilluar

disa ndeshje miqësore me sportistët vendas, një nga të cilat e ka në pasditen e mbërritjes sonë. Na ftojnë ta shikojmë ndeshjen. Por del një pyetje e vështirë: kush do të fitojë? Ata janë njohur edhe me arritjet e skuadrave tona në Lojërat Mesdhetare, në Latakia të Sirisë.

— Sido që të ndodhë, do të fitojë miqësia!

Nuk dihet kush e dha i pari këtë përgjigje. Të dyja palëve na duket e goditur dhe secili e ndien veten autor të saj.

Kjo ngrohtësi na shoqëron deri në fund të qëndrimit në Algjeri, tok me kënaqësinë për zhvillimin e marrëdhënieve midis dy vendeve. Edhe një personalitet i tillë, siç është anëtari i Sekretariatit të Përhershëm të KQ të Partisë së FÇK, Buhara, veteran i Luftës për pavarësi, që na pret të nesërmen e mbërritjes sonë, pas bisedës aq dashamirëse, na përcjell deri në korridor, tek ashensori. Do të vizitojmë Muzeun Historik, vepër e bukur arkitektonike dhe kulturore. Luftën heroike të popullit algjerian për pavarësi kush nuk e njeh. Mbi një milion të rënë.

Ndërsa shohim disa nga reliktet e tyre, mendja më shkon doemos te dëshmorët tanë dhe, thellë në histori, më kujtohen disa detaje që kam parë te shpata e Skënderbeut në Muzeun e Armëve në Vjenë. Ekspozuar sa futesh, diku në të djathtë, ajo vjen mjaft e

imët përballë përmasave të shpatave e parzmoreve të kalorësve e madje dhe të kuajve të tyre, panciret e të cilëve zënë nganjëherë një pavijon të tërë. (Po në histori sa vend zënë vallë?) Më të «druajtur» akoma e përbën një tjetër fakt: shpata është fare e thjeshtë, pothuajse pa asnjë dekoracion, me ndonjë njollë të kohës, plagë që e ka marrë në luftë. Asnjë gram ar, asnjë fije argjend nuk e zbukuron. Vetëm një copë si lëkurë e zezë a si meshin, nga më të zakonshmit, e vesh dorezën, për të mos vrrarë dorën.

Nuk ishte e vështirë për një burrë shteti si ai, që për një çerek shekulli mbrojti qytetërimin evropian, të porosiste diku ca serm e ca flori për shpatën, vetëm për shpatën e luftës, po populli që i varfër, populli që në luftë dhe Gjergji rronte me hallet e tij, me hallet e atdheut. Floriri e argjendi vinin më pas, mjafton që shpata të priste fort e drejt...

Ua tregoj shokëve algjerianë. Mund të jesh popull i vogël, po të bën të madh ideali, çështja që mbron. Në këtë vështrim historitë tona kanë shumë pika takimi. I ndeshim këto pika edhe në fusha të tjera, gjatë vizitës.

Ja dhe Ghardajaja, për të cilën na kanë folur shumë. Qytet turistik në thellësi. Ngrihet në 7 kodrina në mes të shkretëtirës, më saktë, qendra e vilajetit përbëhet prej 7 qytetesh të veçanta, me emra domethënës: Qyteti i Dritës, Mbretëresha, Qyteti i Shenjtë... Nga larg duken si qytete «lodra», të përgatitura nga ndonjë studio filmi, prej dërrase ose kartoni. Aq të rregullta e karakteristike janë.

Sapo kemi zbritur në aeroportin e qytetit, na bëjnë përshtypje dy-tre avionë të vegjël nga Arabia Saudite.

— Janë sheikët. Qyteti ynë është shumë turistik. Kanë ardhur për pushime. Gjuajnë lepuj e gazela. I njihni gazelat?

Ç'mund të gjuash në shkretëtirë? Këtu s'është xhungël. Po ja që rrethina ka edhe botën e saj shtazore. Madje kjo u bë shkak që të njihemi më afër me një pamje të veçanë të pasioneve e këmbënguljes së njerëzve të këtij qyteti. Pasi kemi parë lagjet, tregun karakteristik, kemi hyrë dhe në një shtëpi, shokët algjerianë na propozojnë për të vizituar kopshtin zoologjik. Do të mbeteni të kënaqur, na thonë, po më mirë s'po jua themi që në fillim.

Kopshti është i mbushur me kafshë të

Algjerisë, disa janë marrë dhe me këmbim ose janë blerë nga vende të huaja. Luanët turfullues dhe hijenat si hije pasohen nga dhelpra rrëshqitëse e shkretëtirës, nga struci i druajtur e papagalli optimist. Më tej, kuaj të egër, sorkadhe, akrepa vdekjeprurës dhe gjarpërinj me brirë, tepër të rrezikshëm të shkretëtirës, që aq mirë dinë të fshihen në rërë, na thonë.

Çojnë dhe e thërresin «ustanë». Është krijuesi këmbëngulës dhe pronari i këtij kopshti. Një burrë i moshuar, trupmesatar e me shpatulla të gjera, me ca syze me skelet të trashë, me njërin sy më të vogël se tjetrin, që i jep fytyrës së tij një dinakëri pa të keq, me një kapuç të bardhë të ngjashëm me takijen, pothuajse gjithmonë me një qeshje që ia zbulon dhëmbët e rrallë, se përse të jep përshtypjen e një furrëtari. Vitaliteti i tij nuk bie menjëherë në sy: zbulohet ngadalë deri në befasim.

I afrohet kafazit ku prehet një çakall.

— Rrotullohu, — i thotë arabisht dhe kafsha i bindet si një mekanizëm.

— Tourne-toi, — i thotë frëngjisht dhe gjithçka fillon nga e para.

— Nuk janë dosido kafshët që kam sjellë këtu. Janë me kulturë, — qesh ai dhe syri i vogël i bëhet edhe më i vogël. Janë poliglotë. Po tani do t'ju njoh me Maradonën. Ja fotografia, si fillim.

Ai nxjerr nga xhepi një gazetë të palosur, e cila ka botuar një reportazh të ilustruar nga ky kopsht, një faqe të plotë. Njëra nga fotografitë ka diciturën: «Duke biseduar me Maradonën». Është një cjaç i zi, racë spanjolle, me katër brirë, që zgjat qafën matanë në kafaz e përtyp gjethe të njoma, që e ka pagëzuar me këtë emër.

— E paske mirë me gazetarët, — e ngacmon dikush.

Syri i vogël rrudhet edhe më.

— Merre si ta marrësh. Gazetarët më kanë vënë në siklet. Kam shumë respekt për ta. Kanë shpallur diçka që unë s'e kam e, për të mos i lënë gënjeshtarë, jam i detyruar t'ua plotësoj. Kam tri gra. Ata kanë shkruar katër. Jam i detyruar t'ua plotësoj, ta marr edhe një. Nga halli...

— I ri je, — e nguc dikush.

— Hë, pra. Më rinuan ata, gazetarët, Jam 75 vjeç. Ata kanë shkruar 71. Kur je 71, mund të martohesh prapë...

Syzet i vetëtijnë. Syzet apo sytë prapa qelqeve?

— Po sa fëmijë ke, — e pyesim.

— Jo dhe aq. Kam 28 gjithsej. Nga këta 18 janë djem.

— Po nipër e mbesa?

— Kjo është pyetje e zorshme, më ngatërron gjithmonë kjo pyetje. Duhet ta saktësoj përgjigjen. Deri në mëngjes kisha 143

nipër e mbesa. Të shohim mos ka ndonjë ndryshim... Nejse, fundja, edhe po të ketë, ju s'jenë gazetarë...

Pasioni i fuqishëm në punë dhe humori i mirë e optimizmi, ja mbase sekretet e vitalitetit të këtij burri. Algjerianët janë njerëz të çiltër, të hapur, dhe humori s'i mungon.

Gjatë një dreke në Tizi-Uzu, shpallim «konkursin e anekdotave». Natyrisht, ne, «pala shqiptare», parapëlqejnë anekdotat politike. Ata dëgjojnë, qeshin fort, pastaj nuk ngurojnë të tregojnë edhe vetë të tilla. Vlerësojnë, herë-herë të entuziazmuar, qëndrimet e vendit tonë. Si, si? Asnjë borxh? Dhe çmimet 17 herë janë ulur? Asnjë kredi, asnjë bazë ushtarake, asnjë këmbë ushtari të huaj... Popujt tanë kanë kaq gjëra të përbashkëta, kanë për të mësuar shumë nga njëri-tjetri.

«Konkursin» megjithatë e fitojmë ne.

— Një shishe verë duam, — u themi, — një «Cuvée du President», për shembull, përveç stimullit moral...

Qytetet e Ghardajasë në pamje të parë janë të gjitha njësoj: ndërsa të bardha të stilit vendas, i vishen kodrës pa lënë asnjë pëllëmbë dhë zbuluar dhe përfundojnë në majë, ku lartohet një minare pa dekoracionet karakteristike me ngjyra, që i gjejmë në Algjer. Po secili në brendësi ka karakteristikat e veta. Ecën nëpër rrugica dhe vë re dri-

taret e vogla në të dy krahët, në katet e sipërme edhe më të vogla, për t'u mbrojtur nga vapa, nga ajri i nxehtë i verës, Shpesh ato janë përkundruall, me qëllim që të bëjë ko-rent ajri për t'i filladitur.

E kundërta ndodh me portat e shtëpive: kurrë nuk janë dy ballë për ballë. I kanë bërë kështu që unë të mos shoh ç'ndodh në shtëpinë tënde, sqaron një nga shoqëruesit. Fanatizmi ka ndikuar te tradita, duke ushqyer rudhjen, vetminë. Deri në ç'masë? Ja, mbi kokat tona shikon se si pikërisht shtëpitë e dy portave që s'duan të shihen kurrë sy më sy, i japin dorën njëra-tjetrës duke u lidhur me një ballkon të gjerë, të mbyllur.

— Këtu poshtë zakoni i ka larguar portat. Atje lart zemrat i kanë rilidhur përsëri. Ato ballkone janë ndërtuar që, në rast rreziku e së keqeje, familjet të mund të komunikojnë me njëra-tjetrën. Një zjarr, një sëmundje, një luftë. Qyteti është sa i ndarë aq dhe i bashkuar.

Ky solidaritet midis njerëzve ndihet kudo. Ngjitemi nëpër një nga rrugicat karakteristike dhe në një portë shohim që hyjnë e zbresin vazhdimisht njerëz. Shoqëruesit na prijnë nëpër shkallët e ngushta e fort të përpjeta. Na shfaqet përpara një odë e madhe, shtruar me qilima. Lëmë këpucët përjashta, ulemi këmbëkryq.

— Do të hamë kus-kus.

Na shërbejnë në një pjatë prej druri ulliri, e madhe sa një tepsi, e mbushur plot me kus-kus. Një gjellë karakteristike algjerriane, që e ndesh, me nuanca dhe në vende të tjera arabe, prej kokrrizash si pilaf, përgatitur nga një miell i posaçëm gruri. Mestitet me perime të ziera me lëngun e tyre, dhe me mish. Po mishin nuk ta hedhin në pjatë. Ta sjellin në qese plastmase. Mbase je i ngopur e s'e ha dot. Atëherë «Merre me vete, në qese e ke e s'të bezdis.»

Familja ku kemi hyrë nuk ka ndonjë sebeb, ndonjë gëzim ose ngjarje tjetër të shënuar dhe këtë s'e ka përgatitur për ne. Është në traditën e banorëve që, kush ka mundësi, përgatit herë pas here dreka me kus-kus, vijnë e hanë fqinjët, të njohurit, por edhe udhëtarët e rastit. Madje, nëse ndonjë familje s'i ka mundësitë ekonomike për ta bërë këtë, atëherë e ndihmojnë të tjerat, që të mos mbetet mbrapa.

Afria dhe solidariteti i njerëzve duken dhe në detajet më të thjeshta. Duke kaluar në një rrugicë të errët, befaz nxin një frëngji në gur. Sipër — një poçe. Është shumë e vjetër kjo poçe, thonë. Është vënë aty për të ndriçuar rrugicën natën. I hedh vaj kush të ketë, e ndez fitylin kush të mundet, ai që kalon i pari. Rëndësi ka që t'u shërbejë njerëzve me drejtësi. Dhe kurrë nuk mbetet bosh. Dhe kurrë s'gjendet e shuar.

Frëngjia është një vepër e vogël arti, jo vetëm me mesazhin që përcjell, por edhe për formën e gdhendur në gur. Këtë art, në përmasa të shumëfishuara e shohim te qendra e shpërndarjes së ujit, diku në rrethinë të qytetit. Një lloj ujësjellësi, me kanale të gjera nëntokësore, për të mbledhur ujërat e shirave të befasishme që shkretëtira e zbrazët është gati t'i përpijë, sikur edhe detin të derdhësh aty. Por ja që nevoja i detyron të gjejnë një mënyrë për të grumbulluar këto ujëra. Përroi i nëndheshëm vjen nëpër kanal in e shtruar me pllaka e baltë të pjekur dhe stop — ka një pritë guri me shumë dritare. Dritaret, të tëra në një nivel e në një madhësi, janë shpërndarëset e ujit, nga aty derdhet në vija më të holla drejt kopshteve me limonë e shegë. Asnjë pikë nuk duhet të rrjedhë më shumë te njëra se te tjetra.

Afrohemi te gryka e nëndheshme. Ke dëshirë të thërresësh me zë të lartë, për të provuar akustikën e kësaj shpelle-banesë e triumfit të jetës mbi vdekjen. Një lloj Skotinie. Një lloj skëterre, kur mendon ç'kanë hequr njerëzit për ta bërë.

— Kjo është shumë e vjetër, — rrudh krahët njëri nga shokët në përgjigje të pyetjes sonë. — Ndoshta shumëshkullore.

Më kujtohet një tregim i Sent-Ekzype-risë për një pilot të rënë në shkretëtirë, ku

çdo kokërr e djegur rërë, nën ajrin që dridhej prej zhegut, i dukej si burim uji që shkumëzon, ndërsa shkumëzonin buzët e tij e përthitheshin nga vdekja. Më kujtohen skenat e njohura të filmave të botës arabe, ku njerëzit dalin e vallëzojnë të çmendur nga gëzimi nën rrebtimin e shiut të shumëpritur. Në Algjeri tani është bërë punë e madhe për të siguruar ujin për njerëzit e për bimët. Këtë më mirë se kudo, do ta shohim në EL Golea, 260 km nga Ghardajaja.

Rruga për në El Golea rrëshqet e gjitha nëpër shkretëtirë. Herë pas here shfaqet një tabelë: *Danger! Le sable!* Stuhitë e rërës i hedhin kokrrizat e imta në asfalt e, po të jesh me shpejtësi, rrëshqet mbi të më keq se të jetë borë. Shikojmë gjithnjë prapa xhamit. Ja dunat me rërë të imët, të imët. Po të shkelësh në to, këmba të sharron deri në gju dhe përpjekja për të bërë një fotografi pranë tyre nuk të kushton pak.

Pastaj fushëtira e thatë ashpërsohet. Gurë, shkëmbinj. Por, për çudi, të tërë të një lartësie. Thua një shpatë kozmike zbriti dhe i këputi të gjitha kreshtat. i sharroi duke i prerë në të njëjtin nivel. Është puna milionavjeçare e erës.

Në majë të një shkëmbi shfaqet një njeri. I shtangur, i ngulur në heshtje, shtatore vetmitare. Ç'bën ai aty, përse nuk lëviz?

Qenka thjesht një siluetë e formuar nga

dikush duke vendosur gurë njërin mbi tjetrin. Në thellësinë time zgjohet vendlindja, klith fëmijnia, me zërin zhbirues deri këtu, në shkretëtirën e Saharës. Më kujtohet një rit pagan: Para se të zbritnin bagëtia nga stannet, në prag të vjeshtës, çobanët ndërtonin në majat më të larta «kacurreta» — burra prej guri. Thoshin që është sevap i madh. Se orët e zanat mërzhiten pa njerëz, i ha vetmia e bjeshkës, thoshin. I kërkojnë ata tban më tban e shpellë më shpellë. U thërresin njerëzve në krojet me myshk, nën ahët e zverdura, te lajthitë e holla. E trishtohen kur s'i gjejnë, u pikëllohen sytë e bukur. Ndaj, kur i shohin këta burra prej guri në majat më të larta, gëzohen: paska mbetur edhe një bari, thonë. Njëherë desha të ndërtoja dhe unë një të tillë, në Majë të Pllanes, 2100 metra mbi nivelin e detit. Qeshë fëmijë e mezi lëvizja gurët. Sa ngrita gurin e parë, nën të turfulloi një nëpërkë e kuqërremtë gjysmë e ngordhur nga etja, që kërceu epshore me një shpresë...

— Po këto silueta, kush i ka ndërtuar?
— pyes Abdullahun, sekretar i komitetit të rinisë të vilajetit. Kërkoj mos gjej një lidhje të brendshme me ritin tonë pagan.

— Kush tjetër, përveç erës.

Unë ngul këmbë që këta janë gurë të vendosur me dorë. Ja ndarjet midis tyre, ja... Kur afroresh, e ndien se janë të çarat e erës.

Ai është një bllok i tërë, një thep që era e ka plasaritur e gdhendur pa e këputur, ndërsa tërë shkëmbin në këmbët e tij e ka bërë shesh. Më vonë do të gjejmë qindra gurë, në të cilët era ka gdhendur mjeshtërisht gjithfarë lulesh të çuditshme. Ahmeti, një djalosh 10-vjeçar në El Golea, i zgjedh me shije e na i dhuron gjithë gëzim.

Lule që «vrasin», perifrazoj me mend Migjenin, duke kujtuar një njoftim të shtypit të këtyre ditëve për dy të rinj palestinezë në tokat e Gazës ose të Cisjordanisë, që sionistët i kapën, i rrahën, i torturuan, i sakatuan, i lidhën, i hipën në avion dhe atje lart, midis pikëllimit të reve, i shtynë te porta e helikopterit për t'i copëtuar në shkëmbinjtë e çatalluar të shkretëtirës, që shfaqeshin turbull në fund të oqeanit ajror. . .

Diku kam kënduar se si të njëjtën gjë patën bërë fashistët italianë në Libi, rreth mesit të këtij shekulli, me luftëtarët kryengritës. Praktikë e parapëlqyer e antinjerëzve. Përkrahja për çështjen arabe, për ato palestineze në veçanti, është një nga pikat e rëndësishme të bisedimeve tona zyrtare.

Kushedi ç'vapë do të bëjë në verë këtu, mendoj, ndërsa shkretëtira bëhet më e rrafshët. S'ka nevojë të pyesësh për këtë, mjafton të shikosh në të majtë e në të djathtë, ku herë pas here duken ca hekurishte të zeza.

Janë mbetje nga gomat e djegura të makinave. Në udhëtim e sipër ndodh që dëmtohen, dhe shoferët i hedhin ndanë udhës. S'ka nevojë t'u vësh shkrepësen. Këtë punë e bëjnë rrezet e diellit, me zhegun përvëlues, dhe ato marrin flakë duke lënë pas ca hekura të ndryshkur, skeletet metalike, nën një shtresë trishtimi.

Si me porosi, shoferi vë një kasetë. Një këngë e përmallshme. Me siguri për ndarjen, i them Abdullahut.


— Pikërisht për ndarjen, — pohon ai.
— Nga e morët vesh?

Një këngë për ndarjen më e trishtë se kudo bëhet në shkretëtirë. Rëra bëhet më e shtruar, shkëmbinj s'ka më, dunat janë tretur. Valle të tilla kanë qenë shkretëtitrat e Urës së Qabesë? Kënga e nizamëve tanë, me mirazhin e vendlindjes në rërën ku aty-këtu ka mbirë ndonjë tufë bar i ashpër, i egër, që arrin të mbijetojë. . .

Ç'është kjo ujdhesë e gjelbër, si një mrekkulli? Kemi arritur në El Golea.

2

Përfytyrimet për oazet, shpeshherë me elemente fantastike, këtu në El Golea, trupë-



zohen e shndërrohen në realitet. Ky qytet, me 32 mijë banorë, ka 32 burime uji, me dhjetëra litra në sekondë secili. Shirat e Saharës derdhen e lëshohen kushedi ku, në ekstremet e saj, e mblidhen në një lumë të nëndheshëm, i cili shkumëzon nën këmbët e këtij qyteti, në errësirën e thellë, përbiron nëpër rërën e lashtë duke kërkuar më kot, nëpër labirintin e mbyllur, rrugën drejt baba-oqeanit.

Po ky lumë është shumë bujar. Për të marrë ujin e tij nuk duhet të shposh thellë. Të gjitha burimet janë gjetur në thellësinë nga 0.75 deri në disa dhjetëra metra, dhe dalin pastaj në rrjedhje të lirë, pa shteruar kurrrë. Përdoren për ujitje dhe për të pirë. Madje ky ujë shitet në të gjithë Algjerinë, i ambalazhuar në shishe të bukura, si ujë mineral. Vendasit krenohen edhe me këtë fakt.

Jo pak, por 200 mijë palma, që prodhojnë në hurmat e famshme arabe, përbëjnë krifën përherë të gjelbër të qytetit. Një kështjellë e vjetër njëmijëvjeçare, që lartësohet rreth njëqind e ca metra mbi sheshin e blertë, përbën përkrenaren e tij të lashtë. Nga gjërat më të çuditshme të saj është bunari (pusi) me diametër vetëm sa mund të lëvizë një njeri, i hapur në qendër të kështjellës, gati 200 metra i thellë.

— Po ta ngulësh kompasin në një pikë dhe ta rrotullosh në mënyrë që të përfshijë

tërë Algjerinë, kjo pikë është El Golea, — na thotë Abdurrahmani.

Megjithatë të duket sikur, duke vësh-truar nga maja e kështjellës, diku matanë, prapa dunave, gjëmon e uturin deti. Ndosh-ta të krijohet kjo ide nga rëra e pafund. Një fakt tjetër ta përforcon: me mijëra gjurmë guaskash janë të gdhendura nëpër gurët e kësaj fortese, saqë për një çast mund të men-dosh se sapo kanë ardhur fëmijët nga plazhi e kanë luajtur me to në basa (plisa) deltine.

Miliona vjet më parë këtu ka mbretë-ruar oqeani i pafund, si zot i plotfuqishëm. Duke u tërhequr, la pas të kundërtën e vet: thatësirën, shkretëtirën e zbrazët e të për-hershme. Gjurmët e detit flasin edhe në «qendrën shkencore» — një lloj muzeu ar-keologjik. Fosile të peshqëve, të dinosaurëve, vezë struci të ngurtësuara, (siç dihet, kjo kaf-shë nuk jeton në Sahara). Drurë që nuk janë kalbur, por, nën ndikimin e vepruesve kimi-kë, janë gurëzuar, duke ruajtur gjithë pamjen si dru: lëvozhgat e çara, rrathët e viteve, ve-tëm përbërja: gur. Lloje rëre të imta si miell, të ngjyrave e nuancave të ndryshme. . .

Të gjitha këto i mbledhin të rinjtë, të cilët punojnë me përkushtim për të grumbu-lluar e ruajtur dëshmitë e hershme kulturo-re të vendit. Edhe në Ghardaja vizituam një shtëpi rinie, që kishte, midis të tjerash, dho-mën e paleontologjisë e të arkeologjisë. Në

shtëpinë e rinisë kalonin kohën e lirë, merrshin me veprimtari çlodhëse e argëtuese, zhvillonin prirjet e talentin mbi 700 djem e vajza. Në dhomën e shahut ose të pingpongut, të mundjes ose të teatrit, të fotografisë ose elektronikës. (Sapo hyjmë në këtë të fundit, lexojmë në ekranin e parë: *Mirë se erdhët, të dashur vëllezër në Ghardaja! Nous vous souhaitons un beau séjour!*)

El Golea, me arkitekturën kombëtare e i mbushur me gjelbërim, (duke parë shtëpizat e tij, të kujtohen lagjet karakteristike të Teheranit, shtëpitë e ulëta me kopshtet e famshme persiane, që të sjellin ndër mend Saadiun e Khajamin), «trembet» shumë nga shirat. Na thonë se, po të bien 50 mm, ekziston rreziku i një katastrofe. Si është e mundur?

Ujërat e burimeve të qytetit përdoren sa përdoren nëpër kopshte e shtëpi, dhe pastaj, në rrjedhje të lirë, derdhen në një liqen, të krijuar nga vetë ato, disa km më tej. Liqeni është i gjatë 7-8 km, dhe qindra metër i gjerë. (Në perëndim të diellit shkojmë në një kodër në breg të tij dhe e soditim. Dëgjohen bretkosat, klithin patat e rosat e egra, shpupuritin shpendët e ujit, tundet kallamishtja. Ku jemi kështu? Dielli i madh, i kuq, që rrëshqet ngadalë prapa dunave, e ndez rërën na sjell në vete). Në rast rreshjesh, ujërat e liqenit mund të ngrihen, edhe atëherë rrje-

dha e burimeve ndërron drejtim, kthehet në të kundërtën, ekziston rreziku i përmytjes së qytetit. Atëherë duhet marrë ndonjë masë. Një masë e tillë mund të ishte thellimi i shtratit të liqenit, që, sido që të ndodhë, ujërat e tepërta të mbeten përherë të strukura në gropën e tij. Por, po të bëhet kjo, na thonë, rrezikon të ulet niveli i burimeve, rrjedha e nëndheshme zbret më poshtë, rëra përherë e ngopur me lagështi, mbi të cilën ngrihet qyteti, do të kullohej e thahej dhe si pasojë? Rreziku që ajo, duke humbur ujin, të humbasë edhe ngjeshjen, lidhjen, të shkrihet. Kjo sjell plasaritjen e tokës, tëhumbjen e saj, pra mundësinë e shembjes së qytetit. Prandaj aktualisht më i mirë është gjendur ekuilibri që ka krijuar vetë natyra, vërtet delikat, por gjithsesi i sigurt, thonë. Ç'ta ngasësh më tej.

Hurmat këtu nuk numërohen, po mjerrisht janë vjelur që në vjeshtë. Megjithatë ndonjë vesh i rrallë varet aty-këtu në degët e palmave, me kokrra të tejpjekura, që kullojnë mjaltë, siç varet ndonjë vile rrushi deri vonë, në pjergullat tona, ndanë oborrit. Duhet të ngjitesh lart si ketër për t'i këputur.

Qysh në Algjer, Zina na ka premtuar një garë të vogël të ngjitjes nëpër palma, për t'i shijuar hurmat në degë. Po këtu tërhiqet, sepse ato tufëza që kanë mbetur janë në drunj shumë të lartë e të vështirë. Në vendosim ta «dënojmë» që s'po e mban fjalën. Bi-

seda sillet pa e kuptuar te mbajtja e fjalës, kalon te besa, si një zakon, si një normë, si një institucion. Fjalët e urta të popullit, balada e Doruntinës dhe e Ali Bukurisë, përpjekja jonë e mundimshme për t'i përkthyer aty për aty disa vargje dhe koeficienti i varfërimit i një përkthimi të shpejtë, aq më tepër diletant.

Ndërkaq në sixhaden mbi barin e lagur nga njomështia e përhershme na qerasin me çajin karakteristik. Tri gota, në intervale të shkurtra, thuajse njëra pas tjetrës. Por jo me shije të njëjtë. E para, pak e fortë, si jeta, thonë. E dyta, me mente, aromatike, si dashuria. Po e treta? Ajo mbyll ciklin me nota optimizmi, është e ëmbël plot sheqer. Këtu, dhe sidomos në Saharanë Perëndimore, përgatitja e këtij çaji përbën një art të vërtetë. Zihet në çajnik, pastaj gruaja që merret me këtë punë me një zell e durim jo të zakonshëm e hedh nga gota në gotë e prapë në çajnik e kështu me rradhë, duke e ngritur dorën shumë lart: currili bie pa u derdhur asnjë pikë dhe gota shkumëzon. Ky veprim përsëritet shumë herë derisa tri të katërtat e gotës mbushen me shkumë dhe vetëm pak çaj është në fund. Gotat janë të vogla, sa një dopioraki te ne.

Shijen e hollë dhe finesën e ndesh që nga gota e çajit, deri te veprat e arkitekturës. Mjafton të vizitosh pazarin e Ghardajasë. Punime leshi, lëkure, prej metali. Penjtë me

ngjyra të ndezura, që nuk i sheh gjetkë. Bojë qielli, rozë, nuancat e jeshiles e të blusë, të gjitha të forta, asnjë e zbehtë, as e shpëlarë. Këto bojëra, na thonë, nuk shlyhen kurrë. Përgatiten me disa gurë të veçantë, që shtypen e treten në ujë. «Zonja kimi», me marifetet e saj, s'arrin të përçudnojë traditën e popullit.

Palmat e hurmave janë të larta. Pranë disave syresh zgjatet një filiz. Rastësi? Jo! Ato janë të moshuara, po nuk lejohet prerja pa i siguruar vazhdimësinë, fidanin që do ta zëvendësojë. Palma njihet dhe për drurin e fortë. Na shpjegojnë se, i përpunuar me vaj ulliri, përdoret në ndërtimet, rron me shekuj. Trarët atje, në kalanë mijëvjeçare, prej palme janë.

Mikpritësit tanë duan të na shtjellojnë gjithçka e po kështu të mësojnë sa më shumë për Shqipërinë. Ndërsa hamë drekë në «El Bustan» e pimë «Le mouflon d'or», fjala sillet te feja. U shpjegojmë që fenë te ne e kanë sjellë pushtuesit, dhe prandaj kemi pasur tri besime, u flasim për rolin përçarës që kanë luajtur këto fe duke u shërbyer interesave të të huajve, pastaj se si vete populli e veçanërisht rinia e demaskuan këtë rol. Tundin këna.

— Drejt keni vepruar, në kushtet tuaja. Libani e dëshmon qartë këtë. Përçarja bart në potencë thelbin e një tragjedie kombëtare.

Nuk e ndiejmë si kalojnë orët. Vetëm kur dëgjojmë:

— Tani kemi një surprizë të vogël.

3

Makinat marrin kthesën drejt shkretëtirës, në dalje të qytetit. Rëra kërcet nën rrotat e tyre. Krrkrr, dhe më duket sikur po udhëtojmë nëpër borë. Nuk fryn, nuk lëviz një gjeth, sepse tashmë nuk ka fletë, as fije bari, vetëm yjet lëvizin e dridhen në qiell. Ndihet një i ftohtë i lehtë, që buron nga rëra e gurët, nga heshtja e natës ose nga mungesa e gjithçkaje të gjelbër. Befas një dritë vëzullon përpara, dhe në sfondin e saj ca hije të zeza, të mëdha, që lëvizin me përtesë. Janë deve. Ja dhe zjarri, që përpëlitet e kërcen i përmbajtur në derë të çadrës.

— Do ta kalojmë darkën në një çadër beduinësh.

Në oborr takohemi me të zotët e shtëpisë. Shtatë-tetë burra, me mustaqe të zeza e mjekër, me fustane të bardhë, të gjatë, si burime drite, vënë dorën në gjoks e takohen me ne duke na uruar mirëseardhjen. Pastaj na prijnë në çadër.

— Urdhëroni, urdhëroni, «mahraben».

Ulemi nëpër sixhadet karakteristike, «rahat llokum». Jashtë vetëtin zjarri dhe nata e gjelbër si pyll luhatet në thellësi, sikur do të kompensojë mungesën e blerimit.

Nëpër të gjitha vendet dhe kohërat arkitektura ka ndryshuar: ajo mban diçka nga shekulli i vet, nga populli që e ka ngritur. Ndërsa çadrat janë të thjeshta, nga një kontinent në tjetrin, nga ciganët te beduinët ose arixhinjtë, po ato mbeten. Ngritur mbi shkopinj, mbuluar me. . .

Ja, pikërisht këtu shfaqet origjinaliteti. Çadrat këtu janë të mbuluara me një pëlhurë të trashë me vija të gjera, pa kontraste të dukshme, të endur me lesh dhie dhe deveje. Kjo pëlhurë nuk përshkohet prej shiut: pikat e rumbullakëta lëshohen me vrull e rrotullohen si të trullosura, duke u rrokullisur poshtë strehëve. Më kujtojnë cergat tona të endura me lesh dhie, që shtroheshin në vend të qilimave, mbi fier, në odat e varfra dhe që pëlqeheshin aq shumë: vërtet të ashpra e jo aq fine, por fukarait i bënë shumë punë, s'dinin të griseshin kurrë. Pastaj dhe gunat e dhirta e mestet e dhirta që mbatheshin me opinga nëpër borë, se nuk të lagej këmba.

Rrotull çadrës brenda — jastëkë të punuar dhe samarët e deveve.

Për mirëseardhje na sjellin dy tase të mëdha me qumësht, që i kalojmë dorë më dorë, ulur këmbëkryq. Kështu na pritën edhe

në drekë, sapo arritëm, në një kopsht plot fllad, rrethuar me mandarina të ndezura, me palma e blegërima delesh, (pa dhen nuk ka kopsht, thonë): qumësht të freskët me hurmat e njohura, krejt të tejdukshme. Kjo është tradita. Në përputhje me këtë, në zonën e Kabilisë, (u folëm për aksionin tonë të ullirit, dhe ata, duke na përmbushur dëshirën, na çuan me kënaqësi në një ullishtë dhe në tri fabrika vaji përfaqësuese: një moderne, një tradicionale dhe një shumë e lashtë, «primitive», ku një lloj mokre, e rrotulluar me dorë, ndonjëherë dhe me kafshë, shtypte ullirin vetëm pasi ky të ishte bërë stafidhe, duke nxjerrë vaj «tepër të pastër», «ilac»), pra në këtë zonë qerasja ishte tjetër: fiq të thatë, që i ngjyeje në vaj ulliri, ndonjëherë shoqëruar me kulaç. . .

Nuk vonohet një darkë shumë karakteristike, me shish të gatuar mjeshtërisht, me çorbë pikante, me kus-kus e përsëri me mish të pjekur e sallatë jeshile.

Më vjen ndër mend Zelfanaja. Ishim shtruar për drekë në një oborr me bar dhe, nga mesi, Omari thotë:

— Tani do të ndërrojmë «tavolinë».

Bën me shenië. Prapa shpatullave tona, përshkuar nga helli i mbështetur horizontalisht në dy furkëza, shtrihet një dash i therur, i pjekur me kujdes të madh. Na shpjegojnë që, sipas zakonit, ky hahet në këmbë, pa

thika e pirunë. Piruni, në fund të fundit, ka imituar dorën, bën shaka dikush.

Afrohemi. Të gjithë presin. Pastaj:

— Filloni ju, — thotë njëri nga shokët algjerianë. Zakoni është të fillojë miku. Dhe këtë mish e bëjmë për miq veçanërisht të nderuar.

Këtë e kuptojmë edhe vetë. Shumë më e thjeshtë e pa telashe do të ishte një drekë në hotelet më të mira ku flemë.

Pjekja është bërë në mënyrë të shkëlqyer. Me erëza e me spec djegës turshi, nga ata «që sytë lot të kuq të nxjerrin», më kujtohet vargu i Dritëroit. Herë pas here shokët algjerianë shkulin ndonjë copë që atyre u duket më e shijshme dhe na e zgjatin. «Merr nga kjo!» Si në Shqipëri.

Mendimet m'i këput një zë pranë derës së çadrës:

— Tani do të shohim një «petite soirée» të përgatitjes së barutit. Ai përgatitej nga tri lëndë: squfur, qymyr dhe e treta blihej, vinte nga larg, një përzierje kimike.

Një ceremoni tipike e nomandëve, e be-
duinëve ose barinjve. Sa funksionale aq dhe artistike.

Jashtë nata dridhet, zjarri kërcet dhe yjet klithin për të trembur gjumin. Në dyja anët, ballë për ballë, janë vendosur dy skua-
dra nga tre veta secila. Burra të pashëm ze-
shkanë, me sy të zinj që shkreprijnë, me mje-

kra të mprehta e qerpikë të kërcyer, kanë marrë në duar veglat e domosdoshme: ca si vorba druri me fund shumë të ngushtë, shkopinjtë trashë e të shkurtër me kokë të rrumbullakët — shtypës ose thika, dhe kanë hedhur në fund të enës përzierjen e tri lëndëve në raportet e caktuara. Secili shikon «kundërshtarit» që ka përballë, e përshkon me një dritë të fuqishme, sikur do ta mundë me sy. Në çadër qetësi e plotë dhe njëfarë ankthi.

Trak — si në një orkestër, pa dirigjent, por me sa duket u morën vesh me sy — të gjashtë shkopinjtë godasin me dorën e djathtë fundin e gjashtë enëve të drunjta, që ata i mbajnë fort shtrënguar midis gjunjëve dhe ndërkaq, me dorën e majtë shtrirë drejt «kundërshtarit» përballë, lëshojnë një «ah», sikur duan t'i thonë: dorëzohu. Për disa pjesë të sekondës veprimi përsëritet, por me një ndryshim: fundi tashmë goditet me dorën e majtë dhe e djathta i thotë shokut përballë: e shikon? Dhe vazhdon ky alternim i pasthirrmave të gjoksit me ritmin e goditjeve në fund të vorbës, që vjen i mbytur e tingëllues, me një harmonizim të shkëlqyer. Ah-tring-ah-tring... shoqëruar me alternim po aq ritmik të duarve. Sytë u shkëndijojnë duke paralajmëruar zjarrin.

Me se mund të zbutet kjo skenë epike? Na vjen në ndihmë një fyell i hollë, përmallshëm. Nga del kjo melodi baritore, nga the-

llësia e shkretëtirës, ndonjë beduin që ruan devetë matanë, luhatet pylli i palmave tej, apo është vetë nata që fishkëllen nën buzë e mallëngjyer? Melodia është gjithandej e shkrirë në nëpër thërrmijat e ajrit e të rërës, gjithnjë në sfond. Pastaj një daulle. Tepër butë, si për të ndjellë gjumin, gishtat e dikujt ose të diçkaje godasin kaq ëmbëlsisht lëkurën e tendosur. Ku janë?

Orkestra është aty, dy hapa larg nesh, ngjitur me mjeshtërit e barutit. Aty është fyelli, aty njeriu i tupanit, që, vetëm sa e gudu-lis atë, me bulat e buta. Ato shoqërojnë ritmin e goditjeve të shkopinjeve në fund të enëve të drunjta dhe klithmat sugjestionuese të burrave. Dhe prapë fyelli. Dhe kjo tambure. Dhe kjo natë që bredh si fillad e nuk ngulet kurr-kund. Dhe një yll i madh që përpëlitet sipër zjarrit, matanë. Sa kohë kalon kështu?

Në të dyja anët e skuadrave janë vendosur tifozë, që i mbështetin e i nxitin me thirrje. Ndahemi dhe ne, bëhemi «kundërshtare» me njëri-tietrin. Ah-tring, ah-tring... Dhe përsëri fyelli. Dhe kjo tambure e lehtë. Dhe shikimet ngacmuese: mjaft e ke, të mundi. Dhe asnjë pikë dierse në ballë, megjithë mundimin që të shkaktonte çdo lëvizje e shpejtë dhe e prerë.

— U bë, — dëgjohet një zë. — Ta provojmë.

Pluhuri i zi hidhet në shuplakë të dorës.

Shikojeni. Kjo është prova, me sa duket, kontroll me sy. Por jo. Dikush sjell shkrepësen dhe për një çast një vetëtimë e beftë përshkon çadrën, megjithëse na ka marrë malli t'i flasim një reje në qiell. Ai shkund dorën sikur s'ka ndodhur asgjë: lëkura e rryer, e regjur nga puna, nuk e ndien fare barutin që u ndez në shuplakë të dorës.

— Comme un flash, — thotë dikush i kënaqur me efektin.

Kjo ishte sa për provë, ceremonia vazhdon. Pranë ka ardhur dhe është ulur Hatixhja. Ka ndërruar përsëri rrobat. Për të tretën herë, në mos gabohem. Nuk është e dhënë pas modës e fustaneve. Hatixhja është vajzë e thjeshtë, e ngarkuar për punën me të rejat në komitetin e rinisë të dairasë (rajonit). Është mësuese. Flet një frëngjishte shumë të ëmbël, që të rrëshqet te veshi si fëshfërimë. Shumë e gëzuar dhe përherë e gatshme të japë shtjellime për gjithçka. Mbi mollëza i lëshojnë hije (apo dritë) të përherëshme qerpikët «me rrema» dhe vetullat zgjaten e marrin arratinë në një fluturim dallëndysheje. Hatixhja u jep mësim beduinëve.

Kishim dëgjuar edhe më përpara për këta endacakë të shkretëtirës, që lindin në udhëtim dhe në udhëtim vdesin, pa vatër e pa varr. Për këta endacakë — udhërrëfyes të papërsëritshëm, që s'e gabojnë kurrë rrugën midis zallishtës së pafund e stuhive të rërës,

ditën as natën. Orientohen nga yjet, nga erërat. Por edhe nga ajri, nga lagështia e tij ose nga ngopja me pluhur, nga nuhatja, të vetmit që e dallojnë erën e gurit e të rërës. Me këtë dhunti të pashoqe, më të sigurt se çdo busull, na tregojnë se si kanë shpëtuar me dhjetëra herë udhëtarët e hutuar nëpër shkretëtirë, sidomos të huajt. Tani në Algjeri punohet për t'i stabilizuar në qendrat e banuara, nëpër oaze, duke u dhënë shtëpi e kushte të tjera për jetesë, bëhen përpjekje për t'i arsimuar. Dhe Hatixhja është njëra nga mësueset. Nuk të vjen çudi kur, para se të hysh në çadër, në terrin e hollë, ndien dorën e saj që të kap te bërryli:

— Ja një nxënës imi.

Përpara dallohej vetëm hija e një burri.

— Mos u çuditni, — sqaron. — Nxënësit, disa, i kam më të mëdhenj se veten. Nga trupi po e po, por dhe nga mosha. Beduinët...

Tani e kuptojmë më mirë sa të vështirë, por edhe sa fisnike e ka punën Hatixhja. Duhet takt i veçantë, mençuri e fisnikëri, që nuk i mungojnë kësaj vajze të thjeshtë të popullit. Nxënësit e saj, paçka se më të rritur, skuqen deri te veshët kur i thërret e i ngarkon me diçka, janë gati t'i bien në gjunjë në rërë dhe fluturojnë për t'ia mbaruar sa më shpejt porosinë.

— Janë të mrekullueshëm, — thotë me një gëzim të singertë.

Shohim njërin nga nxënësit, që mezi ecën, shalakatet sa në të majtë, në të djathtë. Ka të metë në këllqet, në eshtrat e legenit. Jeta në shkretëtirë ka bërë të vetën, sëmurdjet, mungesa e kujdesit mjekësor, e kaluara. . .

Hatixhja tani është ulur pranë nesh. Për ta përmbushur më mirë kuadrin folklorik, ka ndërruar rrobat, është veshur krejtësisht me kostumin popullor të zonës. Fustani i hollë, me tyl të përgatitur këtu, jeleku, vathët, byzylykët prej argjendi. . . Ajo të flet me kënaqësi për teknikat e përgatitjes. Ndërsa ceremonia e barutit vazhdon, tashmë një spektakël i mirëfilltë artistik.

Dikush është ngritur për të kërcyer. Ritmi është shumë i shpejtë, tepër i nxituar, e tëllë është dhe vallja: si arrin t'i lëvizë këmbët dhe trupin ky djalosh? Ja, po i dridhen gjunjët. Është i dehur. Nuk është efekti i alkoolit, që ai s'e vë në buzë. Njeriu dehet nga shumë gjëra. Është muzika që ka depërtuar në çdo pore të lëkurës së tij, në çdo qelizë, dhe ai është ndezur. Fytyra i është zbardhur, flokët ngjitur nga djersa mbi ballë, sytë perënduar. Këmbët nuk lëvizin, ato fekojnë, ato vetëtijnë. . . Ku e kemi parë këtë fytyrë? Por ai nuk duron më. Lëshohet mbi qilim. Ku e kemi parë këtë djalë? I japin ujë. Ngrihet

përsëri. Ah-ah-tring-tring. . . Dhe ai fyell plot ndjenjë. Dhe ajo daulle e butë si zemër. Djaloshi vazhdon, sa nuk njihet. Është tjetërsuar në ekstazë. Qenka njëri nga shoferët që na ka shoqëruar me makinë nga Ghardajaja! Tring-ah. . .

Kjo është valle shumë e shpejtë. Është, si të thuash, për solist — krejt ndryshe nga ajo që pamë dy-tri orë përpara, në oborrin e bukur plot gjelbërim të hotelit «El Bustan» (kopshti), përgatitur posaçërisht për nder të delegacionit tonë. Mbi pesëdhjetë burra, (grupi i valltarëve është më i madh, i përtërirë me të rinj, por aty s'kishte vend për të gjithë), hidhnin një valle të kënduar, që u uronte mirëseardhje miqve nga Shqipëria. Shoqërohej me të vetmen muzike — disa vegla metalike që i mbanin në dorë e që tingëllinin duke u përplasur lehtë. Ruanin ritmin në mënyrë të përsosur.

— Si kastanjetat këto, — i them Abdullahut.

— Kastanjetat spanjolle këtej e kanë origjinën. Ato janë përpunuar në shekuj. Këto janë «mëmat», janë origjinali.

Algjeria ka një pasuri të madhe folklorike. Dhe bëhet kujdes për ta ruajtur e zhvilluar. Në Tizi-Uzu pamë përgatitjet që bëheshin për festivalin folklorik kombëtar. që ata e bëjnë çdo vit. Në skenë luante një grup i njohur popullor, në sallë vallëzonin fëmijët.

U shpjegojmë që në Shqipëri vlerësohet shumë folklori. U flasim edhe për Festivalin e Gjirokastrës. Ata janë të një mendimi me ne, se në thelb ruajtja e zhvillimi i folklorit është kulturë, por edhe detyrë atdhetare. Sidomos për kombet e popujt e vegjël. Njëri nga shokët tanë, Luli, u kujton këngëtareshen algjeriane Zekija Mohamed, që e kemi parë disa herë në televizionin tonë.

Ata rrudhin krahët.

— Nuk e dimë ku është, — thonë. — Duhet të jetë jashtë. Po kemi plot Zekija të tjera. . .

Ata buzëqeshin «për ta ngushëlluar Lulin», që s'do ta shohë dot Zekijen. Pastaj njëri nga shokët thotë diçka për Vaçe Zelën. E ka parë në videokasetë në ambasadën tonë. Kanë dëgjuar pikërisht «Valsin e lumturisë», bashkë me këngët e tjera të festivalit të fundit të këngës në Radio-Televizion.

— Gurgullon, — thotë, — ka diçka nga Edit Piafi.

— Por. . . ndoshta pak më e ëmbël, — themi.

Mbase dhe kemi të drejtë. Po mbase na duket më e ëmbël se është shqiptare. . .

Kur do të mbarojë kjo mbrëmje e bukur në çadër, sa barut do të përgatitin?

Nuk e dimë. Arusha e Madhe është rrëzuar goxha nga kupa e qiellit. Venera digjet e digjet, Ylli Polar ndriçon me vetëmohim,

ashtu si prej miliona vjetësh... Ja, në këtë krah i takon Shqipëria.

— Fêtes des bonnes réves! — dëgjojmë një zë tashmë të njohur në hollin e hotelit, ndërsa marrim çelësat e dhomave tona.

Por a ka kohë për të parë ëndrra? Pas dy orësh do të shkrepë dielli.

... Një javë midis miqsh kalon shpejt, pa u ndier. Jemi duke mbledhur plaçkat në hotelin «Alxhekur». Pas disa orësh «Mazdat» tona do të marrin udhën e aeroportit. Në një xhëp të valixhes më zë syri diçka të mbësh-tjellë me letër të bardhë, që e kisha harruar. E hap.

— Hidhe, se do të të prishë rrobat, — më thotë Luli.

Ai zgjat dorën për ta marrë dhe kontro-llon mos ka lënë ndonjë gjurmë të lehtë në astarin e valixhes.

— Jo, — i them, dhe ia kap dorën. Mos e luaj...

Për disa çaste harrohem në mendime.

— Është një lloj suxhuku me erëza, që «ta mbledh stomakun, mos të të zërë makina ose avioni». Ma ka dhënë nana. E ka përga-titur vetë dhe e ka vënë me dorën e saj aty. Lëre...

Ngado që vete, Nana është ajo që më ndjek gjithmonë pas. Shqipëria...

Mars, 1988

Lundrimtarë

Një ditë pas mbërritjes së delegacionit tonë, më datën një dhjetor, mbi qiellin e Lisbonës u ngrit një avion me zhurmë gërryese dhe, në fluturim e sipër, shpalosi një flamur. Udha e këtij avioni, që u nis nëpër ajrin e lagur, do të ishte tepër e shkurtër, më e shkurtër se gjerësia e qytetit.

Njëkohësisht me të nëpër rrugët e kryeqytetit portugez u nis një turmë në rreshta të zinj: qindra veta ecnin duke hedhur parulla të ndryshme e duke thirrur: «Ne jemi portugezët e vërtetë!» Vargu i tyre kaloi pra-

në mureve, ku një natë më parë punëtorët kishin grisur pllakatet fashiste. Ai kaloi jo larg një ndërtese krejt të kaltër, që çohet mbi kodrat buzë oqeanit. Është qendra e forcave të NATO-s. Me bukurinë e saj hutuese, kjo ndërtesë i ngjan një mine gjigante, të cilën valët e kanë hedhur natën fshehurazi në breg, për të gënjyer dikë ditën.

Për disa orë rresht kolona u zgjat e u përdrodh si një gjarpër i madh shëtitoreve e shesheve. Ishte ky një manifestim fashist, i mbrojtur edhe nga avionë. Ishin fashistët ata që ngjireshin pa pushim: «Ne jemi portugezët e vërtetë!»

Gadishulli Iberik është ndër ata që e ka ndier më herët e deri në kockë sëpatën gjakatare të fashizmit. Prej plagëve të historisë së këtij gadishulli, Atlantiku është i kuq.

Portugezët e vërtetë janë të tjerë, të tjerë...

Ne ishim një delegacion gazetarësh nga RPSSH, të ftuar për të marrë pjesë në 4-vjetorin e gazetës «Voz do Povo». Me ne ishte dhe një grup i vogël artistik me amatorë të këngës popullore, kryesisht studentë. Festa u zhvillua në Kaskais, një qytet bregdetar rreth 40 km larg Lisbonës, me vila e pallate

të stileve të ndryshme, sipas kohës kur janë ndërtuar apo shijeve të pronarëve të tyre. Aty organizatorët kishin mundur të blinin një sallë rreth 8000 vendëshe, një pallat sporti. Kishin ardhur përfaqësues të masave popullore nga tërë Portugalia dhe nëntë grupe artistike nga vende të huaja të Evropës, Amerikës Latine dhe Afrikës.

Ndër këngët e para që u kënduan nga kompleksi GAK, mjaft i njohur në Portugal, ishte «La cantiga est una arma» (kënga është një armë). Në sallë kumbonte zëri i një artisti portugez: *Nuk mjafton vetëm kitara për ne, duhet dhe guximi*. Dy net vazhdoi festa; gati 12 orë zgjati ajo në secilën natë. Për këtë arsye njerëzit lëviznin vazhdimisht, ca hynin e ca dilnin. Por erdhi një çast natën e parë, kur rrjedhat e shikuesve, që donin të dilnin, pothuajse u shterën, ndërsa nga portat e sallës vërshuan brenda të tjerë, që ishin rrotull. Ky ishte çasti kur spikeri njoftoi se i jepej fjala kryetarit të delegacionit shqiptar dhe fill pas tij në skenë do të ngjitej grupi folklorik nga ky vend.

Shqipëria në hartë i ngjan pëllëmbës së një fëmije të vendosur rastësisht në buzë të Adriatikut. . . Po Shqipëria është një pëllëmbë e shtrënguar miqësie.

(Tri net më parë kishin zbritur në aeroportin e Zyrihut. Mes alpeve zvicerane fijaste borë e hollë dhe era e liqenit të priste në ato

orë të vona. Qytet i huaj, i panjohur, me një shkëlqim të akullt dimri. Hera e parë që shoh shqiptarë këtu, na tha ftohtë njëra nga punonjëset e aeroportit. Pastaj papritur u shkund:

— Shqiptarë? Ju e vlerësoni shumë pavarësinë tuaj. Për këtë ju çmojmë shumë. Të nesërmen na përcolli në aeroport duke na dhënë adresën e numrin e telefonit të shtëpisë, ta njoftonim, kudo që të ndodhej, sa herë të venim ne a shqiptarë të tjerë aty).

Këngët e bukura të popullit tonë priten me kënaqësi. Qindra të rinj e të reja, të kapur dorë për dore, vallëzojnë nën ritmin e tyre. Rrotull, njerëz të ndryshëm kanë hapur magnetofonët: incizojnë. Për ta janë krejt të panjohura fjalët, po zërat e meloditë u vijnë të njohura dhe të dashura.

Në shtypin e atyshëm u botuan vetëm dy njoftime të shkurtra për festën. Njëri prej tyre shoqërohej me një fotografi nga shfaqja jonë. Në të dyja lajmet, përshëndetja jonë dhe koncerti, (ne dhamë edhe një natën e dytë), quheshin kulmi i festës. Ndërsa televizioni i Lisbonës ftoi grupin tonë për të regjistruar disa këngë.

Pas disa ditësh, në një hotel, një punonjëse e moshuar, që sillte mëngjesin, shtangu e habitur sa na pa:

— Ua, shqiptarët! Dale t'ju puth të gjithë! Ju pamë në televizor e na kënaqët!

Por edhe ne jemi kënaqur. Na ka mbetur në mendje një skenë nga shfaqja e grupit humoristik të punëtorëve të Lisbonës, që luajti disa intermexo:

— Na ishte njëherë një varkë me katër veta. Lëkundej varka në oqean. Befas ranë dallgët dhe ajo u përmbys, të katër u mbytën. Por. . . njëri shpëtoi.

— Shpëtoi! Cili, presidenti?

— Jo, u mbyt.

— Kryeministri?

— Jo, u mbyt.

— Kunjali?

— Jo, u mbyt.

— . . . ?

— Të katër që ishin në varkë u mbytën.

— Po atëherë kush shpëtoi?

— Portugalia.

Mijëra veta në sallë, qeshin e duartrokasin.

Vila Franka është zonë industriale e Lisbonës. Në një ditë të mjegullt me shi ajri aty duket më i rënduar, si i plumbtë. Në qendër të Lisbonës është një magazinë tepër luksoze e borgjezisë së lartë, nëpër katet e së cilës, midis dritave e gjelbërimit natyror, rrjedhin ujëvara që duken si natyrore; ndërsa këtu,

në Vila Franka, rrjedh ujëvara e tmerrshme e sëmundjeve e pislëkut, ujërat e zeza tërë shkumë të qytetit vijnë nëpër një kanal të zbuluar, era e rëndë e të cilit të ngacmon nga shumë larg. Në qendër të Lisbonës është një hotel rreth 30-katësh, nga më luksozët, i destinuar kryesisht për monopolistët amerikanë e të tjerë të huaj; ndërsa këtu, në Vila Franka, në qoftë se një çift i ri punëtor arrin më në fund të gjejë një strehë, çfarëdo, vetëm për të paguar qiranë e kësaj «shtëpie», atij mund të mos i mjaftojnë pagat e burrit e të gruas së bashku.

Njohëm nga afër një punëtor, të cilin pak vjet më parë e patën dërguar urgjent në një spital të Lisbonës, të aksidentuar shumë rëndë. Mjekët thanë se s'kishte shpëtim. Shkuan më pas të afërmit e shokët: nuk e gjetën në spital. Kërko e pyet, asnjë përgjigje. Atëherë, me buzë shtrënguar e gjunjë të dridhur zbritën për ta marrë në morg. Befas, nga thellësitë, si në një ëndërr plot ankth, u dëgjua një zë i mekur, që mallkonte dikë. Shtrirë në hyrje të morgut ishte njeriu i tyre i dashur. Prej më shumë se 24 orë luftonte me vdekjen; i futur me pahir në shtëpinë e saj, nuk dorëzohej. Nëmte e truante me zë të shterur ata që e kishin varrosur së gjalli.

— Po nuk do të vdes, për inat tuaj, —
thërriste. . .

Edhe këtu në Vila Franka, midis qetë-

sisë së gjelbër, zverdhon një ndërtesë e mënjanuar, rrethuar me një gardh të hekurt. Spital, thua kur e sheh. Por jo. Kjo ndërtesë e milionat që derdhen aty nuk shërojnë. Ata sëmurin. Kjo është qendra bërthamore, ku rrezatohet pa pushim shkatërrim për shëndetin e jetën e punëtorëve. Shumë protesta janë bërë për ta prishur. Edhe në festën e «Voz do Povos» u ngrit një këngë proteste kundër saj. Por ajo vazhdon rrezatimin e vet, e verdhë si vdekja.

Në Byllem të Lisbonës, buzë lumit Tezh, që ngjan si gji deti, një monument madhështor vërvitet drejt oqeanit. Ai u kushtohet lundrimtarëve trima, Vasko de Gamës e të tjerëve, që u nisën pikërisht nga ky vend, duke sfiduar dallgët, me etjen e guximin e zbuluesit të skajeve më të panjohura të globit. Ka shumë legjenda e tregime të vërteta për ta, për stuhitë midis ujërave, për urinë e pammëshirshme që i detyronte njerëzit të brenin lëkurën e direktëve, për ndeshjet me piratët...

Legjendat e tregimet për piratët nuk i përkasin vetëm asaj së kaluare të largët. Në anën tjetër të lumit, në Lisnavë, mund të hasësh gjurmët e thella të piratit më të madh të gjithë kohëve. Të piratit kapital. Veçse flamuri i tij nuk feks nëpër terr në formën e dy këckave të kryqëzuara në pëlhurë të zezë. Ai shpesh shkëlqen me drita marramendëse.

Lisnava është një kantier i gjerë, një

ndërmarrje me afro 10.000 punonjës, ku riparohen ose ndërtohen anije mbi gjysmëmiliontonëshe. Për të shkuar në «sallën e papunësisë», (një sallë e madhe gjithë zhurmë, letra e tym cigaresh, pa një pllakat në mur e pa një gozhdë për të varur xhaketën), ku do të bëjmë një bisedë me punëtorët e do të japim një koncert, kalojmë pranë «panairit të sendeve të vjedhura». Kështu quhet një shesh i vogël, ku më përpara vjedhësit ordinerë shitnin me ngut «gjahun» e tyre. Po vendi i vërtetë i hajdutëve nuk është ky shesh i vogël. Përkundrazi, është gjithë kjo hapësirë ku shtrohet ndërmarrja, në të cilën vijnë e riparohen anije tregtare nga kontinente të ndryshme, nga Lindja e Perëndimi. Vijnë këtu. se krahu i punës është më i lirë, dhe punëtorit portugez mund t'i vjedhësh e t'i grabitësh më shumë djersë e gjak, më shumë mbivlerë.

Në Lisnavë çdo lëvizje e punëtorëve është e kontrolluar, regjistrohet me makina elektronike. Edhe kur ha drekë, edhe kur je në punë, edhe kur del nga puna, edhe kur sypërlotur e dhëmbështrënguar shkon te koka e shokut të vrarë, pas të ndjek gjithnjë vëzhgimi i ftohtë i kameras. . .

Makinën tonë e rrethojnë punëtorët. Me ta shtrëngoimë duart si të njohur të vjetër. Ja një fytyrë e pjekur, me flokët prerë shkurt. Ku e kam parë? Me siguri në ndonjë nga takimet e mëparshme.

— Javën e fundit na u dogjën të gjallë dy shokë, — tregon njëri. — Na ndodhin dendur aksidente. Ja, shiko.

Punëtorët vareshin në bashin tërë ndryshk të një vapori të madh, midis dallgëve që vinin e përplaseshin dhe shiut që binte pa pushim. Pa një mushama e pa një palë çizme, duke u përpëlitur në lagështirën therëse midis jetës dhe vdekjes.

— Aksidentet në sy i kemi më të shpeshta.

(Sytë). Një ditë vizitua një fabrikë qeramike. Ky është një art tradicional për popullin portugez. Dhjetëra punëtorë përkuleshin mbi modelet, duke u harruar në vizatimet e imta, pa ngritur as kokën, në një vend pune shumë të ngushtë, rreth një metër katror për secilin. Të gjithë të rinj. Po pikërisht këtu qëndron drama e tyre: aty asnjëri nuk arrin të plakët. Nga mosha 30-35 vjeç drita e syve nis e venitet, shkëlqimi e bukuria e syve rinorë thithen ngadalë nga lulet e ngrira të qeramikës dhe punëtori, i papërshtatshëm më për atë punë tepër të hollë, vërtitet në një muzg të përherëshëm, me shpresën e pashpresë për të gjetur ndonjë punë të përshtatshme për njerëz pa sy. Pak dritë për ata që s'mund ta gëzojnë dritën.

Bregdeti i Portugalisë nuk ka vetëm ndërtuesit e anijeve. Ka edhe peshkatarët. Në Nazare arrijmë shumë vonë, në prag të mesnatës, por ata na presin. Na presin me një darkë tipike, me peshk e me verë dhe me një koncert të organizuar posaçërisht për ne. Vallet e shpejta e të gëzueshme popullore na përfshijnë në çast në vorbullën e tyre.

Pastaj nis një këngë e gëzuar. Diçka për punën e për dashurinë. Por ja, ritmi i saj nis e zbehet dhe mbi këngë ndehet trishtimi si një mjegull e hollë mbi det. Ajo flet për peshkatarët që nisen nëpër ujëra e u thonë lamtumirë grave. Lamtumirë se... deti është i egër, oh, ç'jetë e vështirë! Deti papritur mund të shndërrohet në një varr. Varr i pafund e i paanë. Asnjë tufë lule s'i vihet dot kujt te koka. Vetëm kurorat e shkumëzuara të valëve që s'fllenë. Vetëm një këngë vaji e mpiksur mbi buzë si një etje shkretëtire. Dhe një rrobë e zezë si nata varur në shtëpi. . .

Midis grave e vajzave që na presin, shumë janë me futa e fustane të zeza. Vitin e kaluar këtu u mbytën 5 peshkatarë. Gjatë një shekulli, 280 burra u fundosën në honet ujore. Këtu varkat e peshkimit janë përherë në det të hapur: ka njëqind vjet që vazhdon lufta për një port, por asgjë s'është bërë, sepse ndërtimi i tij do t'ua prishte bukurinë qytetit dhe brigjeve, ku nxirren fitime shumë

të mëdha nëpërmjet turizmit. Do ta prishte këtë «bukuri që vret».

Na shpjegojnë se gjithë qeveritë dhe burrat e shtetit kanë premtuar, sidomos në prag të zgjedhjeve, po këto fjalë janë shkruar me shkumë. Salazari gati 40 vjet kështu. «Do ta ndërtojmë, do ta. . .» Edhe sivjet thonë që «do ta. . .», thonë që e ka marrë përsipër një shoqëri e huaj.

Na ishin njëherë ca peshkatarë që ëndërronin të kishin një port. . .

Alentezha. Fusha të gjera me argatë. Nevoja ua ka mprehur shumë shikimin në shënjestër për të ndjekur lepujt kaçubave me vesë a zogjtë në fluturim, pasi, megjithëse janë të shquar në tërë Portugalinë si rritës të lopëve, derrave e dhenve, siç na thanë, mi-shi për ta ka qenë «mollë e ndaluar». Tufat dhe tokat ishin pronë e latifondistëve të mëdhenj. Pas rënies së diktaturës së hapur fa-shiste të Salazarit, (25 prill 1974), në këto zona u zbatua reforma agrare dhe bujqit luftojnë të ruajnë ato përfitime që patën prej saj. Në kooperativën bujqësore të Çiborës na pritën me entuziazëm. Në mur, në ballë të ndërtesës kryesore, ishte vënë një parullë e madhe, që përshëndeste ardhjen e miqve

shqiptarë. Në sallën ku do të zhvillojmë bisedën e do të jepen koncertet, (yni dhe i tyre), njerëzit kanë hipur edhe nëpër dritare.

Ja, na thotë një anëtar i grupit artistik, këtë fizarmonikë e ruajmë prej 44 vjetësh, gati gjysmë shekulli. Ja dhe kostumet e krahinës — të ndryshme për çdo pjesëtar të grupit. Ja dhe kjo valle shumë e gjallë që pombyllet. Kjo pjesë titullohet «e ardhmja». Gjithë vallja njihet me emrin «e shkuara, e tashmja, e ardhmja. . .».

Jo shumë larg nga kjo kooperativë ngrihet një qytet, në mesjetë i dyti në vend për nga madhësia. Evora. Me monumente kulturre, ku dallon një kishë e shekullit të 15-të, e përmendur sidomos për punimet e gdhendura në kockë. U nisëm për të parë këto punime. Befas, në një nga sallat anekse, midis tymit të rëndë e dritës së mekur të qirinjve shfaqet një njeri. Qëndrojmë kureshtarë. Marrim vesh se aty meshohet për një të vdekur dhe kthehemi. Po nuk kishte vetëm brenda të vdekur. Të vdekurit e pakallur na prisnin te porta e madhe: plaka me rroba të zeza, me supe të rëna e shikim të shuar, fëmijë të plakur pa kaluar ende rininë, me sy të trishtuar e duar që zgjaten për t'u falur ndonjë send, qoftë dhe gjysmë eskudoje.

— E shikoni atje?

Njëri nga shokët portugezë, që na ka pritur në Evora, shtrin krahun drejt fushës.

Midis pemëve, nëpër mjegullën e shprishur, që ngrihet nga arat, shquhen ku çatia e ku muret e një manastiri. Është manastiri Ordem Kartusho. Shumë i pasur, na thonë, me depozita kolosale në bankë, që askush s'e di nga i vijnë. Tepër misterioz në vetminë e fushës. Tepër i pakuptuar e i frikshëm për njerëzit e lënë në prapambetje e analfabetizëm. Gjatë shumë viteve aty vinte Salazari, fshehtëzi, duke zhbiruar natën dhe po kështu, pa u ndier, rrëshqiste e ikte. Askush nga populli s'e dinte pse vinte e çfarë bënte. Vetëm u përhapën fjalë se në atë manastir jetuokësh Hitleri, i cili qenkësh gjallë. Kushedi ç'projekton në bodrumet sekrete me harta nëpër duar, me fytyrën e tretur e të verdhë si flakë qiriri!

Kjo përrallë e zezë, të cilën e përhapin të veshur me petka sa më të besueshme njerëz që u intereson, qarkullon ende. Dy-tre vjet më parë, kur diktatura fashiste në Spanjë vrau pesë revolucionarë, një grup të rinjsh, të revoltuar nga ky barbarizëm i pasardhësve të Hitlerit, u turrën drejt manastirit. Zbritën të egërsuar nëpër shkallët e tij për të shfryrë dufin në njëfarë mënyre. Po mbetën duke u sjellë për një kohë të gjatë nëpër labirinte, pa mundur të gjenin dot as daljen.

Manastiri ka dhe një kanal të nëndheshëm që s'dihet se ku çon. Njerëzit e thje-

shtë s'kanë mundur ta zbulojnë kurrë dredhimin e tij; duke mos pasur asnjë mjet e përkrahje teknike, përveç guximit e urrejtjes së vet, sapo afroheshin u merreshin mendtë e u shtypej gjoksi nga gazet e helmeta. Pak ajër, pak ajër dhe dritë! . . .

Po përralla mbetet përrallë, ndërsa ata që luftojnë për ajrin e dritën e vërtetë janë të gjallë e të fuqishëm. Në emër të punëtorëve të atyshëm afrohet një shok me dy shami të kuqe në dorë dhe ua dhuron ato dy shoqeve tona. Shamitë e kuqe janë simbol i Katerinës, vajzës revolucionare që ra nën plumbat fashistë. (Kënga për të është shumë e përhapur në Portugali. Atë e ka kënduar Tino Flores edhe në televizionin tonë.)

Por. . . prit. Shokët kanë edhe një porosi. Afrohen me një shtambë uji. Është një punim artistik që e kanë gdhendur me mjeshteri duart e një vajze punëtore. Ne e vendosim pranë diskut me këngë.

Katerina rron. Katerinat janë nga ato që nuk vdesin, që rriten vazhdimisht. Jo në manastiret e përrallave e të thikave të pabesisë, po në zemrën e gjerë të popullit.

Pas një udhëtimi të shpejtë nëpër metronë e Lisbonës, në orët e vona të natës arrijmë te një shtëpizë njëkatëshe. Në muret e saj janë afishuar një thënie e Bertolt Breh-

tit për teatrin, etj. Është qendra e një teatri popullor. Këtu kemi shtruar darkën e lamtumirës për miqtë. Të gjithë kanë sjellë diçka me vete: kush verë, kush ëmbëlsira e fruta. Si në Shqipëri, në mbrëmjet familjare...

Sekretari i Shoqatës së Miqësisë Portugali-Shqipëri afrohet buzagaz:

— Kam lexuar diçka për Isa Boletinin. Një hero i vërtetë, tipik shqiptar. Në sallonet e Londrës shkoi me kostum kombëtar dhe nën jelekun kombëtar mbajti koburen rezervë, me të cilën «vrau» ministrin e jashtëm britanik... E kam fjalën e vrau politikisht. Atë dhe tërë diplomacinë e Fuqive të Mëdha. Na tregoni ndonjë gjë më shumë për të, ju lutem!

— Në ç'grup bën pjesë gjuha shqipe? Dua ta mësoj.

— Kam parë në një revistë franceze diçka për origjinën e popullit tuaj. Mund të na e thoni me saktësi, po të ketë mundësi.

— Çfarë botoni në Shqipëri nga letërsia e përbotshme?... Kam lexuar dy romane shqiptare. «Daullet e shiut» (Kështjella), dhe «Komisari Memo». Më kanë pëlqyer shumë.

Ndërkohë 12 telat e kitarës portugeze dridhen tok me violinën tonë, Përveç shokëve të «Voz do Povos», të Shoqatës së Miqësisë, ka këtu punëtorë, specialistë të ndryshëm, artistë, gazetarë, miq të vendit tonë etj. Emri

i Zhose Fleshës është bërë i njohur dhe nga një reportazh i gjatë për vendin tonë, që e ka botuar në pesë numra të njërës prej gazetave më të mëdha të Portugalisë.

— Edhe gjashtë muaj të kisha shkruar, nuk do të kisha shprehur të gjitha ato që ndiej për Shqipërinë, — thotë ai.

Mbrëmja mbyllet me një «suprizë të vogël», siç shprehet njëri nga miqtë, me disa këngë shqiptare, të kënduara nga grupi i Shoqatës së Miqësisë.


Jashtë shndrit Lisbona e bukur. Shkëlqejnë pallatet shumëkatëshe, vetëtijnë dritat pranë kështjellës së lartë të San Georges e Muzeut të Armëve, pranë serrës së luleve.

Një grua na del përpara në rrugë. Se ç'kërkon me ca fletushka në dorë.

— Lyp ndihma për të verbrit.

Të verbërve nuk u duhen ndihmat filantropike, ata kanë nevojë për sytë.

20 dhjetor 1979



Xhambo!

Kishim hyrë në ambasadën tonë me për-shtypjen e parë se Dar-es-Salami qe një qytet mbase jo shumë i zhvilluar, por gjithsesi bashkëkohor, me aeroport modern, me trafik të dendur e plot gjelbërim. Madje edhe ndërtesa e misionit tonë, diku në periferi, dukej më shumë si një shtëpizë e bukur fshati, (kjo më pas do të përforcohej me pëllitjen e dembelosur të lopëve në oborret rrotull, rreth mëngjezit), një dykatëshe e qelqtë, krejt e padukshme në një mjedis baobabësh, mengosh e lloj-lloj drurësh të tjerë që fërko-

heshin në qiell e që në emërtimet e tyre në gjuhën suhaili gjithmonë ka ndonjë bashkëtingëllore të zëshme. Një mrekulli e vogël e këtyre drurëve, sapo u gjendëm në oborr, shfaqej diku në lëvozhgat e trasha të tyre ku, në ndonjë të plasaritur të rastit, kishin ngulur rrënjë lulëshqiponjat, si ato që rritim me aq kujdes nëpër shtëpitë tona. Dhe nga aty kishin marrë një vrull të çuditshëm përgjatë trungut, duke iu veshur atij si kulpra, si larushk, ose thjesht si pjergull. Nga aty i hapnin tërë kënaqësi fletët si krahë shqiponje, me një të blertë të thellë, të mbyllur, që tregon veç shëndet. Më shumë se kaq — harlisje.

Kishim pirë gotat e para me lëng të verdhë frutash dhe nëpër filxhanë po rrihnim me kënaqësi neskafenë e famshme tanzaniane, kur pranë dritares së hollit, ku kishim ndenjur, ia dha një zhurmë e çrregullt, diçka si vrapim i një grumbulli të paorganizuar, i cili mund të përfytyrohet vetëm me shtëllungën e pluhurit mbrapa. Dhe fill pas, një shpërthim thirrjesh karakteristike, në formë sokëllimash të holla e të alternuara me o dhe me u, me të cilit thuajse në të gjithë Afrikën shprehen ndjenjat e fuqishme të gëzimit.

— Kemi sebep, — qesh Kostaqi. — Është ceremonia e synetit të ... vajzave.

Kërshëria fitoi mbi përgjumjen e lodh-

jen e 7-8 orëve udhëtim me avion natën dhe sakaq u gjendëm në livadhin ku dhjetëra gra e vajza kishin ndaluar me gjokset përjashta, duke u tundur e shkundur me ritmin e njohur të papërmbajtshëm të valleve zezake.

— Xhambo, habari.

Komunikimi ynë në suhaili nuk mjaftoi për t'i ngrohur sadopak. Në përgjithësi në këtë ceremoni nuk i pëlqenin të bardhët. Shikues nuk donin. Aq më tepër bezdiseshin nga turistët, shkrap e shkrup me fotoaparate e me kamera.

— Not pikçër, na u afruan me seriozitet.
Not pikçër!

Në njëfarë mënyre gjithsesi po bindeshin për karakterin tonë tepër paqësor. Na rrethuan me një hark valleje që pulsonte në çdo qelizë të organizmit të tyre, pastaj u shkëputën duke iu ripërkushtuar tërësisht ritit të tyre hutues. Epiqendra ishte vajza adoleshente që kishte arritur pjekurinë. Vihet me vrap e të tjerat e ndiqnin me lloj-lloj pasthirmash. Bënte lëvizje karakteristike të duarve e të këmbëve. Shtrihej në bar dhe ato e rrethonin duke e mbyllur shikimin tonë.

Ky rit, sa ekzotik në shikim të parë, aq tragjik në thelbin e tij, në tërë Afrikën e zezë zbatohet nga një numër i madh fisesh. Rreth 50 milionë thuhet, por askush s'e di me saktësi. Praktikohen brisqe të hedhura, që

gjenden rastësisht nëpër rrugë, copëra xhamash ose tehe metalike, pa kurrëfarë dezinfektimi. Shpesh kjo bëhet shkak infeksionesh fatale. Dhe kjo festë, që përruron pjekurinë e vajzës, përruron në të njëjtën kohë kobin e saj.

Shfletoj një revistë të botuar në një kryeqytet perëndimor, i njohur për kolonitë e shumta që ka pasur në Afrikë. Pasi përshkruhet me kompetencë etnografike ky rit, konkludohet thjesht:

Janë fise tepër të prapambetura. Në atë shkallë sa, kur dy gra zihen, për ta poshtëruar në maksimum njëjërën, kundërshtarja i thotë:

— Ik, moj ti e pacipë, që s'je bërë as sy-net. Ke dhe sy e faqe të dalësh para botës!

Kaq. Dhe asnjë fjalë kush e la në këtë prapambetje të papërfytyrueshme njeriun me tokën e nëntokën më të pasur të globit.

Xhambo!

1990

1
2
3

Ekuiunks

Ku janë karafilat, thua me vete duke hedhur shikimin më kot sa në të majtë në të djathtë, nisur nga rekomandimi që të kanë bërë të gjithë në Dar-es-Salam: Mos ikni pa vizituar Zanzibarin, ishullin e karafilave.

Tanzanianët, shumë mikpritës e të çiltër, duan të na kënaqin sa më shumë. Me bukuritë e vendit të tyre të rrallë, me arritjet e popullit, që punon e përpiqet si e si të dalë nga prapambetja e trashëguar.

Por askund nuk duket një vazo, në asnjë cep nuk prushërojnë lulet bojë gjaku.

Kemi vizituar një qendër aksioni të rinisë dhe djersët na kullojnë përgjatë shtyllës kurrizore. Në fytyrë jemi bërë tërë vjuzhga, nga pluhuri i trashë e i zi që na rrethon edhe kur lëvizim me makinë, edhe kur ikim në këmbë. Shohim me zili hijen në pyllin me palma, ku varen arrat e kokosit tërë qumësht, si gjinj mëshqerre. Një pikë fllad nuk fryn. Një fije bar a një fletë nuk lëkundet. Presim me padurim kthimin në qytet për ta njomur buzën me diçka. Ca drurë të lartë, me degë të holla e të imta, kanë ngrirë në kupë të qiellit si të vizituar: një grafikë e gjallë karafilash. Karafilat, këta janë drurë që rrahin qiellin, nuk janë lule saksish.

— Më fund shpëtuam, — thotë Muçana, duke shfryrë si bajloz, i madh e i zi siç është. — Nesër do të bjerë shi.

Ndërsa m'u kujtua se krahasimi me bajlozin në këtë rast nuk shkon, pasi në gjuhën e vendit kjo fjalë përkthehet pikërisht ambasador, pashë rrotull si për të verifikuar nëse shoku që na shoqëronte tha vërtet se do të binte shi, apo ashtu më bënë veshët.

— Do të kënaqemi, — vazhdoi ai duke fshirë me shami qafën e trashë e të zezë, me damarë të dalë, si qafë demi.

Nuk po bënte shaka. Mos ka ndonjë she-një lokale, se shpesh ka tregues zonalë të mrekullueshëm, me të cilët banorët në disa vende parashikojnë saktësisht çdo trill të

motit. Nga mijëra kilometra larg, nga pylli me gështenja në Elezaj më vjen e më përvi-johet këtu, midis palmave e karafilave më të lartë se ahet përftyrimi i Isufit. Isufi qe një plak i urtë, me shpatulla përherë të mbledhura e pak të kërrusura, me kapuçin e bardhë me një rreth djerse në fund, Nuk qe martuar kurrë. Kopshtar i lindur, mjeshtër i aventurave me kafshë, deklamues i palodhur baladash, historish nga më të pabesueshmet, variantesh të panjohura të këngës së Ali Bukurisë dhe i të gjithë Eposit të Kreshnikëve, ky njeri ishte një shkencëtar i vërtetë popullor edhe për motin.

Po mbushnim, (kështu quhet prashitja e misrit për të dytën herë), në log të fshatit, nën një diell të pamëshirshëm korriku, kur Isufi ngriti vetëm pak ballin e tha:

— Atje po bie borë!

Kishte hedhur vetëm një bisht syri nga maja e Shkëlzenit, dhe vazhdoi të prashiste sikur s'donte t'i jepte shumë rëndësi asaj që tha. Mbase për të intriguar më shumë.

Prashitësit qeshën, bashkë me ta edhe unë, që atëherë isha nxënës në gjimnaz, po gjatë verës punoja në kooperativë. Ç'borë tani! Majën e Shkëlzenit vetëm sa e kishin mbështjellë do si re ose mjegulla të përhimta.

Plaku i qetë vazhdoi t'i mëshonte shtatit, thua romuzet që hidhnin nuk kishin të bënin fare me të.

Të nesërmen mali qe pastruar krejtësisht nga floknaja e përthinjur, që e mbësh-tillte një ditë më parë, dhe maja e tij vetë-tinte. Një shtresë e re, e hollë bore e kishte mbuluar dhe zbriste e brishtë deri afër ahi-shtës.

Duke e përjetuar edhe një herë për disa çaste këtë ndodhi të largët, dhe, me sa duket, nën trysninë e saj, (midis popujve ka kaq gjëra të përbashkëta), ktheva sytë nga qielli i Zanzibarit, mos kushedi në ndonjë cep ishte përvjedhur ndonjë re shiu. Po qielli dukej shumë i lodhur e indiferent si një pëlhurë di-kur e kaltër, po tashmë krejt e zbërdhulët nga dielli, ose si një brushtull e gjerë, klorofili i së cilës është tretur ngadalë dhe ajo është gër-zhitur deri në prag të shkrumbit. Për erë as që bëhej fjalë. Gjithçka e ngrirë, e mpirë, pa më të voglën lëvizje. Nuk m'u durua dhe e pyeta shoqëruesin tonë.

— A, po, kjo dihet, — u përgjigj Muçana krejt natyrshëm. — Nesër është 21 mars. Ekuinoksi pranveror. Në këtë ditë gjithë ven-di lahet në shi.

Vendosa të prisja të nesërmen për t'i larë hesapet me dyshimet e mia.

Diku rreth orës 4 të mëngjesit një ëmbël-si e pakuptueshme, gati e ëndërruar, ma nxori gjumin. Kërcitnin fletët e boababëve nën miliona pikla të papërmbajtura, fishkë-llenin degët si një pishnajë në bjeshkë, mijëra

zogj këndonin repertorin e tyre më të zgjedhur, fijet e barit llastoheshin e zgjateshin disa centimetra drejt diellit që po lindte. Në këtë banjë gjithësie të gjelbër e kaq të muzikuar askush nuk mund të fliste. S'duhet humbur rasti për ta soditur e përjetuar nga afër spektaklin e papërsëritshëm.

Tri orë më vonë toka kishte avulluar. Nëpër rrugë nuk kishte pikë balte, thua gjithë ai shi kishte rënë ditë përpara e qe harruar. Kërcitnin kërcëjtë nën tokë e dheu i zi, humus i tëri, bymehej nga vllaga.

T'i besoja a të mos i besoja këtij trilli kaq bujar të natyrës? Këtu edhe shiun ta jepkan «me sahat»!

Rri e mendoj: natyra e gëzon kaq hareshëm ekuinoksin e saj. Po shoqëria e këtij kontinenti zezan të zi?

1990

Trille të tjera

Një klithmë pak e mbytur, që i përshkoi xhamat si një krisje qelqi, na bëri të shihnim në sy njëri-tjetrin, si për të gjetur një shpjegim të shpejtë e sidomos qetësues rreth saj. Qe një zë i tronditur gruaje, që erdhi nga pjesa e pasme e oborrit të ambasadës, një zonë gjithmonë e pandriçuar, madje edhe ditën për diell, për shkak të fletëve shumë të dendura e të mëdha palë-palë. Ndërkaq njëri nga punonjësit, i cili pa dyshim dalloj zërin e së shoqes, kishte zbritur në fund të shkallëve me shpejtësi.

Gruaja kishte qenë duke nxituar për të marrë diçka në apartamentin e vet, kur ashtu në mënyrë të papritur nëpër degë kishte rrëshqitur një frushullimë e shpejtë dhe një qenie përdredhëse, si vetëtimë e zezë, që përplasur mu te majat e këmbëve të saj. Gjarpri, që me sa duket gaboi diçka në llogarinë e tij makabre, vazhdoi të projektonte sinu-soida vdekatare nëpër bar, duke nxjerrë me tërbim gjuhën e kaltër si flakë. Ishte fare e qartë tashmë: sikur vetëm disa pjesë të sekondës gruaja të kishte qenë më përpara në rru-gën e saj, kjo qenie e frikshme, (mbase për ta bërë më tragjike, por sidoqoftë vendasit thoshin se bën pjesë në familjen e kobrës), do të kishte përfunduar në qafën e saj të bardhë, diku poshtë karficës që i mblidhte tufën e flokëve të zes e të dendur, në pjesën e zbuluar të fustanit dekolte. Po rasti nganjëherë është mbret. Dhe kësaj radhe qëlloi të ishte një mbret zemërmirë. E ndryshoi vendimin e tij fatal në sekondën e fundit, duke lënë pas fytyrën e trembur të gruas, që çuditërisht dukej më e brishtë, pra më e bukur, si dhe gjurmët e një ankthi të kapërcyer. Në të njëjtën kohë, duke hapur në tryezën tonë temën e një morie tregimesh për gjarpërinjtë e më pas për kafshët e tjera, si në librat e Xhek Londonit.

Po rasti mbret mund të kishte nënsh-

kruar qysh në fillim edhe një urdhër dashamirësie të pafund. Dhe ja se çfarë.

Udhëtonim për në Mikumi, një nga parqet e panumërta natyrore të Tanzanisë (tri të katërtat e sipërfaqes së këtij vendi, na thonë, është «Serenget»). Xhirafat bëjnë garë me rrezet, kush ta zgjatë qafën më shumë, gazelat kërcejnë si zogj, zebrat përdredhin vithet tërë naze e bufallot katallanë zhgërryhen në llucën e pellgjeve të xhunglës.

Rrugën na e ndërpresin një tufë e madhe kecash lozonjarë. Jo, s'qenkan keca. Një varg i gjatë majmunësh, të hollë e gazmorë, përqeshës e tinëzarë, vrapojnë para makinës, kacavaren nëpër degë, të vegjlit varën në bark të nënave, në formë përçafimi. . . Po luanët? Luanët, lëre mos e nga. Ata mund t'i kesh 5 hapa tutje, shtrirë në bar. Kur zë e shtërngon vapa, ata fshihen midis fijeve të dendura e të larta. Presin muzgun, kur dalin për gjah, duke iu turrur viktimës me krifën e kërleshur. Cila gazelë këmbëhollë ose drenushë bridredhur është e dënuar me vdekje sonte? Rojtarët e rrallë të parkut ngulin këmbë të mos zbresësh në asnjë mënyrë nga makina. Dhe, po s'u binde, të tregojnë një nga historitë e fundit, kur një turist koreanoju-gor, që deshi të filmonte nga afër një luan të zemëruar, la kujtim për t'ia nisur familjes copërat e kameras dhe një urnë me hi. . .

Ndërkaq ç'janë këta që luhaten nëpër degët e drurëve? Ca trungje të prera, që shkojnë ndoshta gjer në një pash gjatësi, varen me litar në degët e forta, që era i lëkund qetë. Gjyshërit baobabë i përkundin si bebe të përkëdhelura, mbështjellë në lulak.

Me një buzëqeshje të fshehtë, si njeriu që do të bëjë një surprizë të këndshme, Kostaqi thotë:

— Ju ka marrë malli për mjaltë? Afrohuni aty e vetëm hapni gojën. . .

Na tregon pastaj se ato janë thjesht zgjoje bletësh. Banorët e gërryejnë trungjet nga brenda. Pasi krijojnë hapësirën e domosdoshme për bletët dhe për mjaltin, i lidhin ashtu nëpër degë. (Më kujtohet se në të kaluarën pak a shumë kështu i përgatitnin fshatarët ato që quhen zgjoje primitive. Në fshatin tim i quanin qengja, ndoshta një variant fonetik i fjalës qyngje. Veçse te ne nuk i varnin në pemë, por i vinin mbi mbështetëse druri, të ngritura paksa mbi tokë.) Prej aty krina e plymtë e bujare zotëron tërë perandorinë e xhunglës, me lule të ëmbla e të mëdha sa fytyra.

Duke kaluar poshtë një druri të tillë, mund të qëllojë papritur të të kullojë në fytyrë si njëra ashtu edhe tjetra, si një rrëke mjalti me aromë të rrallë, ashtu edhe vetëti-

ma e zezë e vdekjes, si ajo që u lëshua në oborrin e pasmë të ambasadës.

Edhe sa kohë mjalti dhe helmi do të bashkëjetojnë kështu dhimbshëm në truallin tënd, Afrikë?

1990

Piedestalet presin

Pasi qemë grumbulluar në sallën e mobiluar mirë të Drejtorisë së jashtme, në aparatin e KQ të Partisë, grupi prej 14 vetash, (në të vërtetë qenë 15 në listë, po njëri s'e mbaj mend për ç'arsye nuk u paraqit), u drejtuam për në katin e tretë, ku na priste sekretari i Komitetit Qendror.

Ai na tha se ne përbënim një delegacion që ishte menduar të shkonte në Iran. Pas fitores së revolucionit, atje organizohej një konferencë e madhe, për të denoncuar krimet e shahut e të padronëve të tij imperialistë.

Delegacioni do të kryesohej nga zëvendësministri i punëve të jashtme.

Foli shkurt për natyrën e qëllimin e delegacionit, si një tjetër dëshmi për mbështetjen që i bëjmë luftës së drejtë të popullit iranian. Dhe qeshi:

— Do ta keni të lehtë, besoj, se edhe emrat i keni myslimanë të gjithë. Ja, për shembull, dhe përmendi disa nga emrat tanë. Keq do ta ketë vetëm Javeri. . .

— Jo, — ndërhyra, — ai është dy herë i fituar: në Lindje bëhet Xhaferr, në Perëndim Zhaver. Gjithsesi mbetet e besueshme, duken si variante fonetike të të njëjtit emër.

Në një atmosferë krejt shoqërore shoqësh u ndamë me porosinë që të bëheshim gati, se nisja mund të ishte fare shpejt. Punë ditësh, mbase.

Fotografitë për pasaportë i bëra menjëherë te fotoreporteri i gazetës sonë, i cili ishte gjithmonë i gatshëm të të ndihmonte, kur ishte fjala për të shkuar jashtë shtetit.

Kaluan ditët, javët u mbushën, po plotësoheshin edhe muaj, dhe asnjë shenjë. Në Iran vazhdonin turbullirat. Ata të drejtorisë së jashtme na thanë se, me sa dukej, Teherani do ta bënte më vonë konferencën, duheshin kuptuar situatat që kalonin. U duk sikur profecia e tyre po vërtetohej plotësisht, kur një ditë na thirrën përsëri. Tashmë delegacioni ishte ndërtuar në një variant tjetër,

dhe numri i anëtarëve ishte më se i përgjysmuar.

— Ata njoftuan se në konferencë nuk presin përfaqësues shtetërorë. Duan vetëm personalitete shoqërore: shkencëtarë, gazetarë, poetë.

Pas këtij shpjegimi, një shurdhëri e re pasoi edhe për nja dy tre muaj të tjerë. Tashmë i humbëm shpresat. Madje gati bezdisesha kur ndonjë shok kujtohej të më pyeste: Hë, ç'po bëhet, kur do të niseni?

Kriza e pengjeve në ambasadën amerikane kishte pushtuar efirin, radiot e TV-të s'kishin të pushuar, agjencitë e lajmeve japnin flash incidentin e padëgjuar të helikopterëve në Tabas, në natën e shkretëtirës, gazetarja e njohur italiane Falaci i kishte marrë një intervistë të çuditshme kryeministrit, që s'do të zgjaste në pushtet, Bazargan, Ish-kolegu i tij Baftjar, nga Parisi, ku kishte kërkuar strehim politik kërcënonte pa ndërprerë se do të rikthehej me dhunë, pa folur për shahun, që s'dëshironte të pajtohej kurrsesi me rënien e dëbimin e tij. Ajatollah Khomeini, nga ana tjetër, paranoiak apo karizmatik, bënte deklarata që botoheshin ose komentoheshin në të gjitha gazetatat e mëdha të botës, ndërsa studentët e universitetit të Teheranit demonstرونin mbështetjen e tyre për revolucionin, duke mbushur rrugët e sheshet. Ndërsa TV i Teheranit transmetonte e trans-

metonte pa ndërprerë seanca nga proceset gjyqësore të bashkëpunëtorëve të shahut, trupat e të cilëve, lavjerrës tragjikë, matnin intensitetin tronditës të ditëve e të orëve.

Të gjitha këto i ndiqja me një vëmendje të veçantë. Rrëzimin e helikopterëve, p.sh., me siguri kam cenë nga të parët që e kam mësuar, pasi e dëgjova rreth orës 3 të mëngjezit në një stacion frengjishtfolës, përkulur pranë radios, i mbështjellë me batanije: një natë që isha roje gatishmërie në redaksi. Këto zhvillime, ndërsa më intrigonin më shumë për të shkuar atje, se të vizitoje një vend si Trani në momente të tilla historike ishte një rast që nuk vjen çdo ditë për një gazetar, po kaq shumë m'i zbehin shpresat se do të realizohej ky udhëtim «fantastik».

Kur gjithçka qe lënë pas dore, një telefon, dhe njoftimi i prerë: për tri ditë do të nisemi. Tashmë ishim katër veta.

Më në fund. . .

Prapa lëmë një natë të butë, të ngopur me avujt e Mesdheut dhe tashmë, mijëra metra poshtë nesh shtrihen shkretëtirat e gjera aziatike në përgjumjen e tyre të thatë. Avioni fluturon drejt Lindjes, në drejtim të njejtë me rrotullimin e tokës dhe, për këtë arsye,

megjithëse ora tregon ende shumë herët, kemi ndjesinë e këndshme që na jep një agim i shpejtë, i cili përcjell një natë më të shkurtër se e zakonshmja. Herë pas here shfaqen majmale të larta, me vezullime të borës që shkrin vazhdimisht nën diellin e nxehtë, pa mundur të njomë një fletë luleje e një fije bari. Shfaqet ndonjë oaz i druajtur, me gjelbërimin e çmuar. Pastaj befas oazet e vërteta: kullat e zeza të naftës, që çohen duke gërvishtur qiellin dhe nervat e supershteteve. Irani.

Nga sa dihet, ne jemi shqiptarët e parë që shkojmë drejt këtij vendi mik. Ndoshta prej dy mijë vjetësh, qysh kur njerëzimi fillon historinë e tij të erës së re, këtu nuk ka qëndruar këmba e ndonjë bashkatdhetarit tonë, të paktën ndonjë i tillë nuk është identifikuar deri më sot.

Avioni fluturon nëpër hapësirën e çelur, pa cak, pa anë. Më kot syri kërkon të çlodhet mbi një copë mjegull, mbi një cukël re.

1

Njëzet minuta me makinë dhe ja, mbi një oborr të bukur, me lule e shatërvanë. çohet ndërtesa 15-katëshe e një hoteli luksoz.

Ai ende thirret me dy emra: qelizat e revolucionit iranian janë shtrirë deri te dy emra të kundërt me njëri-tjetrin. Hiltoni, shoqëri amerikane që merret me hotelet, shkëlqen i shkruar me drita shumëngjyrëshe në dhjetëra kryeqytete të botës. Po në Teheran, pikërisht në prag të konferencës, e cila do të zhvillohet në një nga sallat e këtij hoteli, ky emër u zëvendësua me Esteghlal, që në gjuhën perse do të thotë pavarësi. Irani vazhdon të jetë i dyzuar në të gjitha.

Në konferencë, e cila zhvilloi punimet nga data 2-5 qershor 1980, merrnin pjesë përfaqësues të organizatave të ndryshme, personalitete shoqërore etj. nga afro 60 shtete. Kishte midis tyre edhe ilegale. Ata vinin drejtpërdrejt nga frontet e luftës e të rezistencës, (gjithë punimet e konferencës i ndoqën me fytyrat mbështjellë me shall të gjerë e me sytë nën syze të errëta). Konferenca u hap me një minutë heshtje për të nderuar martirët e revolucionit.

Ditën e parë fjalën e patën pritësit. Nuk fillojmë me një fjalim solemn. Nuk dalin burra me mjekër e me kollare. Një djalë i hollë, jo më shumë se 14-15-vjeçar, i gjatë e i brishtë si një pip, i bukur si hënë e me një zë të ëmbël që të bën të harrohesh krejt, ia merr një kënge që, siç kuptohet, është një sure e kënduar e kuranit. Islamizmi dhe fryma e pavarësisë e revolucionit iranian janë

të mbërthyera keq me njëra-tjetrën, një simbiozë paksa e panatyrshme, dhe do të duhet kohë për të parë kush do të dominojë. Sidoqoftë tani për tani pavarësia është në rend të ditës. Personalitete dhe studiues të fushave të ndryshme iraniane flasin me fakte dhe argumente për historinë e ndërhyrjeve imperialiste në Iran, për grabitjen e naftës, shkatërrimin e ekonomisë, krimet e SAVAK-ut. Diskutimet e miqve fillojnë ditën e dytë.

Po ditën e dytë flasim edhe ne. Delegationit tonë i bëhet një nder i veçantë: jo vetëm i jepet fjala pikërisht të parit për të hapur seancën e pasdrekës, por, ndryshe nga praktika e atyshme, kjo gjë u njoftua qysh në seancën e paradites. Nga vendasit dhe nga pjesa dërrmuese e delegacioneve, fjala jonë, në të cilën shprehej edhe një herë politika e drejtë e parimore e shtetit shqiptar ndaj revolucionit iranian dhe luftërave të drejta të popujve, u prit me duartrokitje, me ndjenja simpatie.

Në pushim, punonjës që shërbenin jashtë sallës së konferencës na u afruan:

— Po të keni një kopje të fjalës suaj, mundësisht, deshëm ta lexonim tani.

Duket paradoksale, po në konferencë mori pjesë edhe imperializmi amerikan. Jo në formën e gjeneralëve të armatosur, as të komandove të përgatitura gjatë... si ata që u bënë stërvina në Tabas. Ai nxori krye në-

përmjet një aktori të shkëlqyer, që mahniti sallën me talentin e tij. Nuk ishte ky një aktor i karrierës, i skenave të Hollivudit, por ishte i prapaskenave të Shtëpisë së Bardhë. Ramsej Klark, ish-ministër i drejtësisë i SHBA në kohën e presidentit Xhonsn, pasi kishte mbuluar me dorashka të bardha njollat e duarve makbethiane të imperializmit, njolla që s'ia lan as oqeani, «në kundërshtim me dëshirën e presidentit Karter», kishte ardhur në Teheran. Elegant, me kostum të thjeshtë veror e pa kollare, ai u shkëput nga rreshtat e fundit të sallës e u ngjit në podium. Ish-prokurori i përgjithshëm amerikan «ngriti në qiell» revolucionin iranian, «dënoi» dhe krimet e imperializmit të shtetit të vet dhe, nga fundi, si rastësisht, kërkoi lirim të pengjeve. . . Zoti Klark foli rreth 40 minuta, me zë tingëllues, me një mimikë të kontrolluar me zotësi. Po një pyetje nga salla, e pasuar me duartrokitje, i turbulloi ujërat. Ç'përgjegjësi keni ju, zoti Klark, kërkoi të dinte një delegat, për ndërhyrjet në Iran, pasi ju keni qenë prokuror i përgjithshëm, ministër i drejtësisë, pjesë e pandarë e makinës shtetërore amerikane? Dhe, veç kësaj, ç'garanci jepni për të ardhmen?

Një digresion, pak histori me dhimbje. Kishim zbritur në aeroportin Mehrabad të Teheranit, freskoheshim me shurup me akull e përpiqeshim të përfytyronim pamjen e këtij vendi 9 vjet më parë. Pikërisht në ditët e para të tetorit 1971 pllakat e përvëluara nga vapa panë një çudi. Papritur ato ishin gjendur të mbuluara me qilimat e rrallë persianë! Po ndodhte një ngjarje e jashtëzakonshme për Iranin. Dhe jo vetëm për Iranin, po për botën mbarë. Shahu Muhamed Reza Pahlavi ishte përgatitur për të festuar 2500-vjetorin e Perandorisë Perse. Dhe qilimat në Mehrabad, (që miqtë e nderuar nga gjithë bota, me të dalë nga avioni, të mos shkelnin fare në tokë), prapëseprapë ishin një masë thujse e parëndësishme me këtë rast. Afër qytetit Shiraz, vendlindjes së poetit të madh Saadi e të lirikut të njohur Hafëz Shiraziu, (që Evropë e njohu kryesisht nëpërmjet Getës, i cili, i mahnitur, përktheu «gazelet» e tij), pranë kolonave të Persepolisit, kryeqytetit të Persisë së Lashtë, u ngrit qyteti i festës. Ai u quajt Kampi i Çarçafit të Artë.

Jo rastësisht ishte pagëzuar kështu. Po më shumë se një vit një urë speciale ajrore kishte lidhur Shirazin me Teheranin dhe

Teheranin me kryeqytetet më të mëdha evropiane. Nga Evropa u sollën tapicerët e piktorët më të mirë. Ata ngritën çadrat në 64 hektarë tokë. I pajisën me çdo gjë të nevojshme për një kamp mbretëror, në përpuhje me shijet ekzotike. I bënë të forta për t'i qëndruar erës së shkretëtirës, që ulërinte duke ngritur kokrriza rëre si lot të ngrirë.

Shumë vjet kërkime të mundimshme ishin dashur për historianët. Përse? Që të përcaktonin me saktësi ç'armë, ç'vegla, ç'muzikë e ç'mjete transporti ishin përdorur 2500 vjet më parë nga Kiri i Madh e që në festë do të imitoheshin me një përpikmëri të jash-tëzakonshme. Shahu shqetësohej mos pada-shur në ndonjë hollësi nuk do t'i ngjante plotësisht atij perandori që ka jetuar para erës së re! Mishrat e gjithë ushqimet e tjera u sollën nga Evropa. Vetëm haviari ishte persian, i famshmi i Kaspikut! Në të gjitha enciklipeditë flitet për kopshtet e mrekullueshme të Persisë, trëndafilave të tyre u kanë kënduar me aq pasion Saadiu a Khajami. Po për kampin e çuditshëm të Persepolisit nuk u gjetën lule në Iran: një Boing special sillte çdo ditë lule të freskëta nga Holanda!

Shahu parakalonte i fryrë, ngjeshur në uniformën e lashtë dhe betohej para sarkofagut: «Kiri. . . fli në paqe gjithmonë, se jemi ne zgjuar». . . Zgjuar, duke ëndërruar ta zmbrapste 25 shekuj historinë, ta rikthente

perandorinë e lashtë, që pati mbuluar Azinë e Vogël, kishte prekur Nilin e qe zgjatur në krahun tjetër deri në Indi. Mes të tjerësh, në këtë ceremoni të paparë ishin të pranishëm S. Agnju, U. Podgorni, J. Tito, udhëheqës kinezë, emirë të Gjirit Persik, e në të njëjtën radhë me ta, qeni i vogël me gjerdan diamantesh në qafë i njërit nga të ftuarit, që u quajt Negus (sovrani) mbi mbretërit.

Të gjithë merrnin pjesë, veç populli jo. Përkundrazi, banorët afër Kampit të Çarçafit të Artë ishin dëbuar njëqind kilometra larg banesave të tyre, në shkretëtirë. Dhe Shirazi dukej më i trishtuar se kurrë nën mbikëqyrjen e përhershme të policisë e të ushtrisë. Për të parandaluar çdo trazirë, në Teheran ishin mbyllur universitetet e licetë. Thua kishte rënë ndonjë epidemi murtaje. Thua kishte pllakosur ndonjë gjëmë vdekatare, që s'e përshkruajnë dot kronikat. E kjo gjëmë ishte e pranishme prej shekujsh mbi Iran: monarkia barbare.

Gjithçka si në përrallat e Një Mijë e Një Netve.

Po mjerisht këtu s'kemi të bëjmë me përrallë, po me një tragjedi reale të afërfundit të shekullit të 20-të. Aktet e saj të kobshme luheshin prej kohësh në kurriz të një populli trim e punëtor, siç është populli iranian, me traditë të mëdha atdhetarie e kulturore. Kjo festë, që kushtoi 300 milionë do-

llarë, ishte vetëm një nga skenat e kësaj tragjodie.

Se mos ishte ky i vetmi rast.

Miliona harxhonte shahu për të përgatitur varrin e tij, (të cilin populli ia bëri pa para!), mauzoleun, ndërsa njerëzit e varfër, mostazafët, fakirfukarenjtë, (siç e përktheu këtë fjalë një anëtar i delegacionit turk), hiqnin shpirt rrugëve, pa një strehë, pa një gur te koka: 42 për qind e familjeve të Teheranit, në vitin 1977, strehoheshin në nga një dhomë të vetme. Le që ç'mund të ishte kjo dhomë! Banja e shahut ishte e artë, ndërsa fëmijët e të varfërve treteshin pa ushqim, pa një ilaç: në Teheran, kryeqytet i vendit, 25 për qind e foshnjave të lindura nuk bëheshin kurrë një vjec.

Nafta rridhte nga nëntoka e pasur. shndërrohej në flori dhe depozitohej në bankat perëndimore me emrin e shahut e të njerëzve të tij. Me 25 banka të tilla kishte lidhje princesha Abdoreza Pahlavi. Princesha tjetër, Ashraf Pahlavi, (mikeshë shumë e ngushtë e Çu En Lait, e pritur me përzemërsi dhe nga Mao Ce Duni), lidhej me 9 banka të tjera. Ndërkaq vendi rrënohej me ritme katastrofike. Gjatë gjashtë vjetve (1972-1978), importi i mallrave u rrit shtatë herë, në një kohë kur eksporti mbeti po ai. Sipas llogaritjeve, vetëm SHBA nxirrnin nga Irani mesatarisht 17 miliardë dollarë në vit. (Vetëm ek-

spertët ushtarakë amerikanë në Iran ishin 40 mijë. Dhe ç'pagë që merrnin: njëqind mijë dollarë në vit secili!).

Për «të rregulluar» sadopak jetën e vendit, shahu pati bërë një «reformë agrare». Pati bërë një reformë shkatërrimtare. Jo vetëm për fshatin, por edhe për qytetin. Pa qenë e nevojshme të hyjmë në shpjegime, po japim vetëm disa nga pasojat e saj: Irani në vitin 1978 importonte mallra agroushqimore afro 23 herë më shumë se në vitin 1970. Në hapësirat e gjera përse ka një sipërfaqe toke të punueshme të barabartë, për shembull, me tokën e punueshme të Francës. Megjithatë Irani u shndërrua në një nga 7 vendet më të varura të botës për nevojat ushqimore.

Gjithë kjo çoi në një shkretim të përgjithshëm të fshatit. Një shpërngulje në masë drejt qytetit. Çdo vit ngarkonin rraqet, vinin e ngjisheshin në bidonvilet e qyteteve mesatarisht 1 milion e gjysmë banorë. Një milion e gjysmë gojë të hapura për bukë. Qindra mijë të papunë që soditnin «mollët e ndalueshme» nëpër vilat e lokalet luksoze. Vinin e ngrinin «banesat» prej copash teneqeje e dërrasash, ku mbledheshin fëmijët barkjash-të. Ngrinin çadrat e grisura, që i pamë anës rrugëve. Ngrinin jetesën e tyre buzë vdekjes.

Sikur s'mjaftonin të gjitha këto, mbi kryet e tyre shahu mprehte vazhdimisht një shpatë: SAVAK-un. Policia e fshehtë, (vetë

emri i saj ngjan si një fjalë onomatopeike, që të kujton fishkëllimën e kamxhikut), SAVAK-u, kontrollonte shtypin, botimet, mbledhjet. Edhe në shtëpitë e tyre njerëzit dridheshin nga ky emër, 60 mijë veta dergjeshin vitet e fundit në burgjet e saj. Për një fjalë goje, për një protestë, 60 mijë veta u nënshtroheshin torturave nga më fantastiket, që nga kamxhiku me kablllo elektrike, goditjet e sakta të specialistëve të karatesë e judos shpeshherë për presion psikologjik në sy të pjesëtarëve të familjes, e deri te karriget elektrike të vdekjes së ngadalshme.

Në një nga sallonet e konferencës pamë një ekspozitë me foto origjinale të marra në qelitë e SAVAK-ut nga vetë njerëzit e saj. Ata i dokumentonin në celulozë krimet e përbindëshme, për t'u mburrur me to përpara shahut. Dhe sa herë shpërthente revoltë në qytete, xhelatët zbritnin nëpër qeli. Zbritnin tok me vdekjen. I lanin hesapet menjëherë me të burgosurit politikë, që për çdo rast t'i kishin duart të «lira». (Kjo ekspozitë mbyllej me një foto domethënëse: një fytyrë e urryer, me potkonjtë nga dielli: gjenerali i SAVAK-ut në tabut. Nën krye, gropa e vdekjes. Mbi krye, pllaka e turpit. Fundi i natyrshëm i të gjithë kriminelëve.)

Kundër kësaj shtypjeje çnjerëzore e të gjithanshme, një lëmsh gjigant urrejtjeje po mblidhej e po mblidhej në të gjithë Iranin.

E premte e zezë. 8 shtator 1978. Në Iran — ditë feste. Dhe vërtet në pamje të parë gjithçka nisi si për festë. Valët e papërmbajtura të njerëzve derdhen nëpër të gjitha rrugët dhe mbushin ish-shëtitorën «Shahbaz», përgjatë disa kilometrave. Por ata nuk këndojnë, siç ndodh zakonisht në gëzime. Ata gjëmojnë. Ata thërresin: «Marg bar shah!» Poshtë shahu! Me grushtet lart, me damarët e qafës të fryrë nga urrejtja. Shahu është vrasës!» Qindra mijëra veta. Ndoshta 1 milion. Më shumë akoma mundët.

Një numër i madh janë veshur me këmishë të bardha. Dhe kjo ka kuptimin e vet. Në traditën persiane këmisha e bardhë paraprin vdekjen e zezë. Ajo të kujton qefinin, e thërret atë. Mijëra e mijëra të rinj që kishin dalë kështu të veshur në demonstratë përbënin armatën e madhe të atyre që kishin vendosur të vdisnin, (gjakun kurorë, pancirin qefin, thotë Firdusi diku në Shahnamenë e famshme). Dhe aq u bënte kur shikonin përballë ushtarët e gardës mbretërore e agjentët e SAVAK-ut. Qindra të tjerë kishin rënë edhe në demonstratën e mëparshme. Të tjerë merrnin mbi supe trupat ende të ngrohtë dhe marshonin duke thirrur për gjakun e tyre, pa pyetur se plumbat dum-dum 12.7 u fishkë-

llenin drejt ballit. (*Mos m'i lidhni sytë me shami, flakët e pushkëve due me i pa me sy, thotë një këngë e popullit tonë.*)

Skuqen këmishët e bardha.

Demonstruesit ngrënë barrikada. Me drurë, me grila dritaresh, me makina të përmbysura, me ç'të mundin. Ndërkohë në sheqin «Zhaleh» rrethimi ngushtohet. «Vëllezër, mos qëlloni kundër vëllezërve tuaj!» Janë motrat dhe nënat iraniane, që kanë mbushur rrugët me demonstruesit dhe ua bëjnë këtë thirrje ushtarëve të armatosur. E ka nxjerrë Irani nga zemra e zemrës këtë thirrje për unitet. Një pjesë e ushtarëve ulin armët. Atëherë ushtria reaksionare qëllon edhe kundër këtyre.

Askush s'e mori vesh me saktësi sa ranë atë ditë. Shtypi shkruante se ishin vrarë të paktën 4000 veta, 4000 nëna kafshuan buzën fort për të mos qarë përballë hasmit. Të nesërmen kolona të gjata njerëzish zgjateshin drejt varrezave të qytetit. Liria është një pemë e veçantë, pëshpëritnin ata. Për t'u rritur, ajo do vetëm gjakun tonë.

Nën rrafshinat e gjera përse gurgullonte nafta. Por një energji më e madhe se e gjithë nafta iraniane po ndizej, duke hapur një greminë të thellë nën këmbët e regjimit feudal gjakatar. Shtjellat e saj gufonin përvëluese. Urrejtja popullore nuk mund të mbahej

më, revolucionin po shpërthente. E premtja e zezë u bë një flamur gjaku që printe.

Kalon nëpër shëtitoret e Teheranit, mbuluar me hijen e dendur të rrapeve, (që na zgjojnë mallin e Shqipërisë), dëgjon shpjegimet e shoqëruesve dhe përpiqesh të përfytyrosh skenat e atyre ditëve. Këtu ishte një barrikadë, te ky shesh u rrethuan disa qindra demonstrues dhe s'mbeti asnjë i gjallë, andej. . .

Shahu kishte nxjerrë një ligj, që ndalonte të kalonin nëpër qytet pas orës 6 pasdite më shumë se dy veta së bashku. Shëtitoreve vërshonin tanket, si bisha shkretëtire. Ndërkaq zgjatej papritur një kokë në dritaren e një banese: «Poshtë shahu!» «Vdekie shahut!» i përgjigjej fqinji pranë. Pasohej kio thirrje nga dritaret, ballkonet, tarracat, ku tanket nuk ngiiteshin dot, edhe brenda disa castesh gjithë Teherani gjëmonte në një demonstratë të paparë, të cilën mund ta ndaloje vetëm po të shembie të gjitha ndërtesat e kryeqytetit iranien, për të mos lënë në këmbë asnjë dritare, asnjë ballkon, asnjë tarracë...

Do të duheshin rreth 60 mijë të vrarë, që të mos vritej Irani. Do të duheshin edhe mbi 100 mijë të gjymtuar, të verbuar, të sakatuar në luftimet e përgjakshme e në torturat, që Irani të mos mbetej i gjymtë, i verbër, sakat.

Kemi lënë pas Rrugën e Fshatarësisë, (përpara revolucionit quhej Elizabet Tejlör — emri i njërës nga «yjet» e Hollivudit), kur befas hiqemi pak mënjanë, si për t'i lënë vend sa më shumë lumit të madh të trafikut, dhe njëri nga guidet thërret:

— Ja ambasada amerikane!

Dy-tri vila që humbin midis gjelbërimit të shumtë, prapa të cilit fshihen dhe ndërtesat e tjera. Ato rrethohen nga një mur i thjeshtë në lartësinë e një avllie që zgjatet qindra metra anës shëtitores. Gjithçka tani duket e qetë e paqësore në atë mjedis të gjelbër midis Teheranit të zhurmshëm e të gjerë. Po kriza e pengjeve tronditi opinionin për muaj të tërë.

Përballë, te hyrja kryesore, një mur-barrikadë prej thasësh. Midis tyre vetëtin gryka e një arme. Dhe mbi të — shikimi i rreptë depërtues i rojës.

— Edhe armët miqve ua morëm.

Ky që flet është një ushtarak që na shoqëron. I ri, simpatik, me sy të zi e me quka në faqe, kur flet e kur qesh, tregon automatikun e tij: markë izraelite. Një armë shumë e përdorshme, pak më e madhe se një pisqollë. Por... me 82 fishekë. Me shkrepje një nga një ose automatike.

— Peshoje!

Islami zgjat armën duke shtrënguar vetë fort rripin e saj.

— I përdorte SAVAK-u në raste terrori. I mbanin përpara me të dyja duart e qëllonin si hitlerianët në Luftën e Dytë Botërore. Ai shkel një sustë, dhe një mashë zgjatet te qyta: tani mund ta mbështetje në sup e të qëlloje duke qëndruar në pozicion.

Islami është kurd. Na thonë se është xhenier i talentuar dhe parashutist. Vetëm 22 vjeç. I martuar. Befas fut dorën në xhepin e brendshëm dhe nxjerr diçka të mbështjellë me kujdes të madh me një letër të tejdukshme. Fotografinë e nuses, thua për një çast, ose të vajzës së vogël. Por jo. Diçka më të shtrenjtë akoma: testamentin e tij. Një testament jo i zakonshëm, që nuk bën fjalë për pronë e për shtëpi, për flori e xhevahire. Bën fjalë për një gjë që nuk matet me gjithë florinjte e botës.

— Këtu kam shkruar amanetin tim, thotë. Të më varrosni në Kurdistan.

Befas shikimi i zbutet. Ngre ngadalë sytë e përmalluar, ëndërrimtarë, sikur do të thotë: luftë është, nuk i dihet. Sikur do të thotë se jetën ia ka kushtuar revolucionit. Atdheut të shtrenjtë, Iranit të gjerë. Dhe duke luftuar për Iranin, luftoj edhe për Kurdistanin tim. Për dheun e për njerëzit. Për nusen, për vajzën. . .

Kjo vendosmëri heroike, për të dhënë jetën në çdo çast për vendin e vet, vetëtin në sytë e çdo iraniani të thjeshtë.

Në mëngjesin e datës 5 qershor fluturonim me një avion të madh drejt Isfahanit. Qytet i madh industrial në Iranin Qendror, rreth 450 km në jug të Teheranit. Me klasë punëtoare, me një rafineri nafte, e dyta në vend për nga madhësia (pas asaj së Abadanit). Me afro 600 mijë banorë. Qendër e vjetër kulturore e shkencore, me një kompleks xhamish që konsiderohen si kryevepra të arkitekturës mesjetare. Pikërisht në vrojtoren e këtij qyteti, një grup shkencëtarësh persë, i drejtuar nga poeti dhe mendimtari i shquar Omar Khajam, (rubairat e të cilit janë shqipëruar aq mjeshtërisht prej Nolit), krijoi, në shekullin XI, kalendarin diellor. Ne shkonim për të marrë pjesë në një ceremoni solemne, me rastin e ditës së dëshmorëve. Është caktuar pikërisht kjo datë në kujtim të kryengritjes që shpërtheu më 5 qershor 1963 kundër regjimit të shahut. Kryengritja që shtypur egërsisht. Toka e zhuritur persiane që lagur me gjakun e 15 mijë bijve e bijave.

Rrugëve të qytetit nuk ka të mbaruar lumi i njerëzve. Ata ndalojnë, brohorasin duke përshëndetur, shumica me grusht, lëshojnë parulla për pavarësinë e vendit. Dhe derdhen drejt sheshit të madh afër pallatit Çel Sotun, (përfunduar së ndërtuari në vitin 1978, me

kolona, kube e piktura të shumta mureve, i caktuar kryesisht për pritje e ceremoni zyrtare). Në të dyja anët e hyrjes së këtij pallati janë rreshtuar familjet e dëshmorëve. Nën atë gratë, vëllezërit e motrat ngrenë lart fotografitë e të rënëve. Thërresin: «Martirët janë përherë të gjallë!» Një nënë mban në duar dy portrete. I çon ato dhe thotë diçka me zë të egërsuar. Ja. dy djemtë më janë vrrarë, thotë. Të bukurit e nënës. Të rinjtë. Trimat. Të gjithë s'e kursejmë jetën. Në këmbë jemi. Në këmbë na ka Irani!

Ajo shikon anash, në të majtë e në të djathtë dhe shton disa fjalë, që s'ia marrim vesh. Me sa duket thotë diçka për dëshmorët e tjerë. Pothuajse të gjithë të rinj. Të rinj dhe të reia.

Ndërkaq mbi njëqind mijë veta janë mbledhur në sheshin ku do të organizohet tubimi. Burrat të rinj, vajza, nëna, gra me femijë. Në këtë shesh të gjelbëruar, me një pishinë të kaltër në mes, ku tre shatërvanë zgjatin nafat e holla si miellma e përviden më kot ta lagështojnë sadopak mikroklimën. Iuanin e argëtoheshin nierëzit e shahut. Lart, në kupë të diellit, një diell i madh, thua kullon plumb të shkrirë. Më shumë se vapa, është thatësira e airit, si dhe në Teheran, që na detron të pimë thuaise pambarimisht ujë me akull ose freskuese të ndrvshme e prapë gjuhën e ndiejmë të thatë, si kadife.

Në mes të sheshit është ngritur një ving disa dhjetëra metra i lartë, nga maja e të cilit gryka e një motopompe derdh e shpërndan pa pushim një shi të dendur mbi njerëzit për t'i flladitur sadopak. E megjithatë, në këtë pik dite të nxehtë, askush s'largohet, askush nuk shfaq shenja lodhjeje, përkundrazi, masa e madhe e njerëzve ngjeshet e ngjeshet vazhdimisht rreth tribunës e përballë saj. Më kalon nëpër mend për një çast shprehja me të cilën një student iranian e mbylli fjalën e tij, që u përcoll me duartrokitje në konferencë:

— Iranin nuk e humbi kush: atë e rifituan ne.

Pyesim kush janë ata që e marrin fjalën. Na thonë se janë studentë, punëtorë, përfaqësues të të gjitha shtresave... Po veçanërisht interesant është fakti se asnjëri nuk mbaron qoftë edhe një paragraf të fjalës së tij: e ndërpresin dhjetëra mijëra zëra njëherësh. Ata shpërthejnë hovshëm, ngrihen dallgë-dallgë, pa u shuar asnjëherë plotësisht, bëjnë të ushtojë qyteti dhe treten në fushën e paanë. Një entuziazëm që flet për gatishmërinë e mbarë popullit iranian për të dhënë gjithçka për pavarësinë e vendit të vet, për përparimin e tij.

Ndërkohë na jepet rasti të bisedojmë me një deputet të zonës. Dikush, anëtar i një delegacioni mik, e pyet nëse ai dhe shokët e tij kanë luftuar kundër shahut.

— 17 vjet rresht, — thotë. — I gjallë jam vetëm kur luftoj. Nëse nuk luftoj, jam i vdekur.

Ndërkaq më kujtohen skenat nga Tabasi. Avionë të djegur, skelete të përçudnuara, ngulur kryq e tërthor rërës. Trupat e komandove, të zinj e rrëqethës: krejtësisht të karbonizuar. Harta origjinale, disa metra e gjatë, (e pamë midis dokumenteve të tjera, kapur agresorëve), në të cilën ata kishin skicuar me hollësi gjithë rrugën që do të bënin helikopterët «Sikorsky RH-539», pastaj makinat «Ford», me të cilat do të hynin në qytet, (siguruar nga agjentët e CIA-s e të shahut), gjithë plani i agresionit të tyre. Dhe në mes të kësaj harte një vulë e gjerë: gjurma e çizmes së ndonjë piloti, i cili, duke u përpjekur të shpëtonte kokën, në panik, shkeli në mes të hartës dhe të të gjithë planit. Vula e turpit imperialist edhe mbi tokën iraniane, edhe mbi hartën e saj.

Portreti i çdo agresori: kufoma të ngulura përgjysmë në rërë nën hekurishtet e brejtura e të çatalluara dhe, në vend të luleve, mbi krye, korba që krrokasin duke u kërkuar sytë!

Populli iranian është punëtor, duarflori, artist me shije të hollë. Kemi përpara një ndërtesë të gjerë, me arkitekturë moderne, rrotull së cilës ka plot lule me një bar të hollë, të prerë aq bukur e në mënyrë të njëtrajtshme, sa të kujton thekët e një sixhadeje. Mjedisi natyror rrotull ndërtesës të përgatit për ato që do të shohësh brenda: muzeu i qilimave të Iranit.

Duart e mrekullueshme perse kanë mahitur botën me mieshtërinë e pashoqe të derdhur në qilima. Nuk dihet fillimi i këtij arti tradicional. që vezullon thellë në muzgun e shekuive. Këtu në muze qilimat më të vietërianë ata të pesë shekuive më parë. pikërisht të shekullit XVI. të periudhës «Savafide». Qilima lesi (dhe lesi më i mirë. na thanë, është ai i deleve që dimërojnë lart në male dhe vetëm në pranverë ulen poshtë e oethen). mëndafshi e pambuku. ose të kombinuar. të përzier herë-herë me fije ari ose argjendi që vetëtimë që larg. të bërë me endie. me një dendësi fantastike. deri në 120 nvia për centimetër katror, domethënë 1 milion e dyqind mië për një metër katror qilim. ose të qëndisur me gilbërë. me grep. në relief. me simetri të habitshme ose me asimetri të studiuar, me skena gjahu, me kafshë të rrafshi-

nave iraniane, me citate të autorëve të lashtë persë, me fletë, me lule, me kopshte trëndafilash. . .

— Mjeshtrit punonin në mes të shkretëtirës, — ndërhyr ciceronia. — Në jetë atyre u mungonte kopshti. Dhe atë që s'e kishin në jetë e futnin në shtëpi me qilimat. Edhe erën e luleve, edhe blerimin.

Një pjesë e mirë e tyre janë endur nga nomadët. I pamë ata në një film dokumentar me ngjyra. Fshatarë të varfër me rraçe lidhur grumbull mbi deve, nëna me foshnjat ngarkuar në lpungë, (një si çantë e posaçme për të mbajtur fëmijën mbi shpinë, që e kanë përdorur edhe nënat tona në udhëtimet e largëta), dele që dihatin nën zhegun përvëlues, rërë që djeg, diell që pjek. Ndalojnë ndajnatë në një qoshe dhe ngrenë çadrat. Fillojnë menjëherë nga puna. Kush ngre avlëmendin, kush nxjerr penjtë dhe, midis avujve që të zënë frymën, me mëngët përveshur përgatitin solucionet për ngjyrosje. Nuk kanë bojëra speciale për këto punë. Ku t'i gjejnë, kush t'ua sjellë, me se t'i blejnë? Po kanë lëkurë shege, gjethe rrushi, lëvore, fletë, barëra të ndryshme që vetëm ata dinë t'i përziejnë aq mirë në doza të caktuara dhe të formojnë me to ngjyra që nuk zbehen kurrë, që rrojnë aq sa edhe peri. Më kujtohet fëmijënia. Barinjët e bjeshkës seku nxirrnin nga dheu një bojë me të cilën lyenin kabloshët

(balluket) e deleve ose kurrizin, një bojë që rronte sa leshi i deleve e që e quanin botë. Një bojë-botë, nga e kishte marrë këtë emër?

Njëri nga vizitorët pyet për çmimin.

— Nuk e di, përgjigjet ciceronia me mi-rësjiellje dhe buzëqesh. — Nuk jam marrë ndonjëherë me shitjen e tyre.

Po çmimi i vërtetë i këtyre kryeveprave nuk caktohet dot. Ato janë punuar kryesisht nga njerëzit e varfër, nga më shkretanët. Sepse ata kërkonin fare pak për mundin e artin e tyre të rrallë. Fare pak, sa për të mbajtur frymën. Paçka se një qilim atyre u kushton sa syri. Thua në vend të pikave të bojës përdorin pika gjaku. Me ditë të tëra pa ngritur kokën nga kjo punë kaq e hollë, që lyp tendosje të jashtëzakonshme, përqendrim. Shtohet në qilim një lule dhe në ballë shtohet një rrudhë. Ndizet në qilim një ngjyrë, por zbehet e zbardhet floku. Çel në qilim një lulishte, po tashmë mbi të është venitur drita e syve e s'e gëzon dot këtë bukuri që vret. Kryevepra, e endur me talentin që të shtang, tjetërsohet pa e nxjerrë ende mirë nga duart.

Qilimat janë të gjithë pa firmën e autorit. Ata kanë një autor gjenial: popullin. Ka prej tyre që janë deri në 100 metra katrorë (16x6 metra), një copë e tërë. Një livadh i tërë, që s'e vyshk bryma, që s'e than acari. Ku nuk kanë shkuar këta qilima; nëpër sallo-net e Evropës e të Amerikës s'ka mbetur kë-

mbë milioneri e takë zonjusheje pa shkelur mbi ta, ndërsa prodhuesit e tyre tërë jetën rendin zbathur shkretëtirës!

Këtë shpirt prej artisti, ndjenjat e pasura, zemrën e gjerë e bujare të popullit iranian, mikpritjen e tij të njohur, i gjen në çdo rrugë, të çdo njeri i thjeshtë që shkëmben dy fjalë. Të qeshur e jashtëzakonisht komunikues, temperamente të gjalla, të ngulin sytë e mëdhenj përshkues tejteje e të flasin plot çiltërsi.

Në lagjen «Xhamoro», në veri të Teheranit, kemi qëndruar për disa minuta. Soditim shtëpitë, gjelbërimin (rrape, arra, mana, dredhëza, lulështrydhe kokërrmëdha të kuqe, trëndafila dhe një lloj luleje erëmjaltë, që në persisht e thërresin jas). Mali mbi ne, krejt i zhveshur, si një piramidë faraonësh, rrezaton nxehtësinë e një reflektori gjigant. Befas hapet një derë. Del një grua me tabaka në dorë. I drejtohet autobusit. Sjell ndonja 8 a 10 gota me copa akulli. Pastaj edhe një tabaka, edhe një, edhe një.

Për të gjithë, Askush nuk i tha, askush s'iu lut për këtë. Vetëm pa që ishim të huaj, që ishim miq, që ishim zhegitur fort e djer-sët na kullonin. Për gjithë ditët që qëndruam, kjo qe një dukuri e zakonshme. Ku një lëng pjepri, ku një akullore me mjaltë, ku thjesht një përshëndetje dashamirëse:

— Salam alekim!

Më kujtohet zakoni i vjetër i nënave tonave, për të vënë gjithmonë një copë mish më shumë në vorbën e fasuleve. Duhej për mysafirin e mundshëm.

Mijëra kilometra larg atdheut socialist, ndërsa sheh një re të bardhë në fund të horizontit e të duket se është shkëputur butë nga mali i Dajtit e Shkëlzeni, ndërsa njerëzit që mësojnë nga je të rrethojnë me dhjetëra pyetje, që nuk di cilës t'i përgjigjesh më parë, vargjet e Naimit *Ti, Shqipëri, më jep nder, më jep emrin shqipëtar*, të duken më të fuqishme e më të vërteta se kurrë.

— Kam pasur rast të vizitoj vendin tuaj. Dy javë qëndrova me pushime. Ruaj kujtime shumë të mira për vendin, për njerëzit, — na thotë, kur sapo kemi arritur, një punonjës i Ministrisë së Punëve të Jashtme të Iranit. Ai më përpara ka punuar si diplomat në një vend ballkanik. — Besoj se tani e tutje do t'i zgjerojmë marrëdhëniet në shumë fusha.

— Shqipëria e vogël, Shqipëria e madhe, — ndërhyjnë një tjetër. — Mirë se erdhët! Shqiptarët janë trima, punëtorë, burra të vërtetë. Qëndrimi i vendit tuaj është heroik dhe të ngjall krenari. (Dhe krenarinë për emrin shqiptar. . .)

. . . Në aeroportin e Beogradit pamë dy burra të gjatë, me kostum. Mundet babë e bir. Vinin nga kurbeti a shkonin në kurbet, (ditët e kurbetit, nanë, qofshin të mallkue-

me...), ku ta dish? Sytë e tyre të ngulur diku tej nuk thoshin gjë. Të dy mbanin qelshë shqiptare në kokë. Të dy i kishin duart të zëna: shtrëngonin valixhet dhe nga një çifte-li të mbështjellë me kujdes.

Pothuajse gjatë të pesë ditëve në Teheran na shogëroi dhe një vajzë studente. E quanin Suela (Soheila, emri i një ylli, i cili, sipas mitologjisë, me dritën e tij u jep ngjyrë luleve, u jep ngjyrë pemëve). Pyetjet e saj për Shqipërinë disa herë ishin të çuditshme. Sidomos në fillim:

— Besoj se nuk do të mërzhiteni nga unë, — thoshte. — Dua të mësoj të vërtetën nga ju. Pastaj kam plot shoqe e shokë që më mbytën me pyetje. Në shtëpi po se po.

Një mësuese e anglishtes në Isfahan ndahet me ne duke na e rikujtuar dëshirën e saj për t'i dërguar disa libra e materiale njohëse për vendin tonë. Shembulli i Shqipërisë është interesant, thotë. Ai frymëzon për të qëndruar me vendosmëri duke u mbështetur në popullin tënd.

Para se të ndahemi, Suela dëshiron të na takojë të katër ne anëtarët e delegacionit. Ka diçka për të na dhënë. Një kujtim të thjeshtë, thotë. Ndonjë kartolinë, ndonjë libër me autograf? Jo. Disa monedha (rial), në faqen e pasme të të cilave është një tufë me karafila të kuq. Ajo shpjegon se monedha të tilla, me karafila, ka fare pak, ajo mezi i ka

gjetur, midis shokëve. Pastaj na jep një re-
vistë të ilustruar. Në kapak, midis të tjerash,
ka shkruar:

*Tani unë po e kuptoj se Shqipëria është
një vend me të vërtetë i pavarur. . . Ju do të
jeni përherë në zemrën time. . . Hoda Nafëz
(mirupafshim)!*

Sa të bukura, aq me temperament këto
vajza. Dhe të duket se më shumë se kujtdo
këtyre u shkon krahasimi i këngëve tona
popullore «syrin filxhan». Lirizmi flokëver-
dhë eseninian s'kish si të mos derdhej ashtu
rebel për persiankat që e shndërrojnë shkret-
tëtirën në luhnajë!

Hoda Nafëz! Për herë të parë më vjen
keq e ndiej dhimbje që nuk botoj më poezi...

7

Rrotull universitetit të Teheranit, në
majdiset e tij, në rrugën përballë, në çdo orë
të ditës ka studentë. Zakonisht i takon grupe-
-grupe, të mbledhur, tek diskutojnë me pa-
sion. Të duket sikur kanë provim e grumbu-
llohen rreth shokut që sapo doli nga salla
dhe e pyesin: «Ç'tezë të ra? Si u përgjigje?»
Por jo. Ata vërtet diskutojnë për provim, por
jo siç bëhet në një sezon të zakonshëm. Ata

rrahin mendime për provimin më të madh në jetë, të cilit i nënshtrohet një popull i tërë: për revolucionin.

— Revolucionin politik e bëmë, — thonë —. E përmbysëm shahun. Tani duhet ta bëjmë dhe në fushën ekonomike, kulturore.

Ngjitemi në katin e tretë të një ndërtese të thjeshtë. Është qendra e studentëve Xhohade Sozan Degi. Djem e vajza të veshura thjesht, rrotull disa tryezave, gjithash-tu të thjeshta, na presin me dashamirësi.

I pyesim si mendojnë për riorganizimin e universitetit e të shkollave të larta.

— Ne kemi një synim. E para, që nga auditorët tona të mos dalin shërbëtorë të imperializmit, por të dalin vetëm njerëz të lidhur me popullin. Irani të nxjerrë për Iranin. E dyta, këta njerëz të mos jenë thjesht teknikë, thjesht specialistë. Të lidhen gjerësisht me nevojat e vendit.

Tutje, në mes drurëve të gjelbër, duket një pedestal. Ndonja 10 metra i lartë. Ashtu, pa përmendoren, ngjan si një trup pa kokë: sipër tij ka qenë vendosur statuja e shahut. Populli e rrëzoi. Në të gjithë Teheranin pedestallet kështu janë, pa statuja, pa ato statuja që u kushtoheshin vetëm shokëve e njerëzve të tij. Thua një kosë e cuditshme ra me fishkëllimë vdekjeje e i këputi të gjitha njëherësh. Kosa e zemërimit popullor.

Dhjetëra veta u vranë kur u shemb ajo

statujë përballë universitetit, na thanë. Vijnin njerëzit e afroheshin drejt monumentit duke brohoritur pikërisht për shahun, për lavdinë e tij, që të rrojë sa Elburzi, sa jeta vetë. . . Befas, nga kjo turmë e dalldisur në ekstazë nga «dashuria» për shahun, shkëputej një pjesë që hidhte me urrejtje parulla kundër tij, e thërriste me emrin e vërtetë: vrasës. Vëmendja e ushtrisë dhe e policisë drejtohej pikërisht nga kjo turmë «plangprishëse»: hutoheshin duke qëlluar, duke ndjekur, duke vrarë, për ta shpërndarë atë. Ndërkaq pjesa që mbetej përfitonte nga tollovia e organizuar me zgjuarsi, njerëzit ngjiteshin me shpejtësi dhe për pak çaste statuja shembej me rropamë, duke u thërrmuar mbi kokat e SAVAK-ut kanibal. Piedestali mbetej. Piedestalet nuk mund të rrinë cungje. Mbi këto piedestale nesër do të vendosen aty statujat e proletarëve e të fshatarëve të shtypur, të mostazafeve, të studentëve e intelektualëve atdhëtarë, bij të popullit, që i shërbejnë me besnikëri atij dhe vetëm atij e truallit që i lindi.

Piedestalet presin. Historia ka për të folur ende.

Qershor, 1980

KARAFIL
DHE TË
TJERA

Karafil

Dita e fundit qe më e ngarkuara e të gjitha ditëve në Vjenë. Fizikisht po që po, por edhe psikologjikisht. I përjetova të gjitha: edhe tronditjen e thellë, edhe ndjenjën e fyerjes në thelbin tim si njeri, edhe... sharrjet më banale, (më pas këto do të më kujtonin atë anektodën për Kristoforidhin dhe plakën që shiste vezë). Megjithëse, për paradoks, austriaku deri atëherë i qetë, që më breshëroi me to, në përmbajtje s'kishte asgjë kundër meje, përkundrazi.

Në një ditë të tillë ideja për të udhëtuar

në Semmering e meritonte plotësisht të quhej shpëtimgtare. Semmeringu do të ishte si një happy end real, aspak i sajuar, që do t'u vinte kapakun të gjithave. Mora frymë i lehtësuar, si atëherë kur, pas një halli që të ka kapluar, shkëputesh te një shok i mirë, zbrazesh me të, i cilruar, dhe sikur i hedh mënjanë të gjitha. Ky shok do të ishte Karl Gega me veprën e tij, tunelin e famshëm.

Në Baden pimë kafe në një klub, ku turistë të moshave mbi gjashtëdhjetë vjeç vallëzonin sipas stilit aristokrat, me një gjallëri të pabesueshme, duke zbuluar te vetja «këngën e mjellmës» te vrullit të rinisë. Luanin tango, valse e fokstrote modëperënduara. Dhietë minuta më vonë makina fluturonte nëpër një tunel pyllor. Nëpër deqet e kapërthurura të laithive e krekcave, frasherave e blireve, shkozëbardhave e mellëzave, bungieve e ndonjë qershie të egër, anës një lumthi të fshehur e vende-vende të tharë, ku bishtnon-te rruga, rrallë arrinte të ndërfaqej ndonjë rreze e imët dielli.

Nuk vonoi e udha u shndërrua në një spirale blu që dredhonte drejt qiellit. (Semmeringu është afërsisht në lartësinë e Dajtit dhe, përjashto infrastrukturën moderne, të kuiton pikërisht Daitin.) Nëpër korsite e saj, njësoi si në fushë, vraponin çmendurisht kamionë të rëndë transporti, (diku ndërtohej një urë që bashkonte dy maja mali, të paktën

250-300 m e lartë) vetura gjithfarësh, ndonjë autobus. . . Në të dy krahët, një pishnaje adoleshente, e mirëmbajtur deri në përkëdhelje, mbrohej nga një gardh i hollë teli. E pamundur të këputje aty qoftë dhe një lulëshqerrë të vetme. Këtu «mblihdh lule», po deshe!

Nuk dëshiroja më të kujtoja asnjë detaj të vetëm nga Mathauzeni. Në kraharror ishte gjithnië e pranishme përhumbia e asaj humnere që më ishte hapur në fillim të po asaj dite. Pamje të çrregullta, të palidhura mirë, si në një studio montazhi, më dilnin përpara syve. pashtjelloheshin me njëra-tietrën, kthielloheshin, turbulloheshin, me vështirësonin frymëmarrjen.

Ato konture mesietare të kampit me mure kështiellore, kundruar së largu. Buzë Danubit. Në një bregore të lartë strategjike të tii, vetëm 170 km larg Vienës, ose sot dicka më shumë se një orë me makinë. Përballë një ishulli paqësor, të mbvitur me bimësi, të krijuar nga ribashkimi i lumit të ndarë diku më tej. (Në një përqaqim të turbullt, atv lumi sikur kishte rënë shtatzënë me blerimin). Ato ujëra që rrëshqasin rëndë-rëndë e të heshtura, të prerë, si plumbi i shkrirë. Thua përpqiden të bëjnë të paditurën për ato që kanë parë e dëgjuar. Thua përpqiden t'i shmangen përgjegjesisë historike, duke sajuar një alibi prej

njeriu të ngopur, që di vetëm të thotë unë nuk di, nuk pashë gjë, unë. . .

Danubi blu ku është? Përveç valseve të Shtrausit e përfytyrimeve të rinisë, mos u mundo ta gjesh tjetërkund!

Ende na kapërcyer portën e verbër, ku në vend të Luçiferit kërcënojnë një palë zinxhirë të stërrëndë e shumëfunksionalë, (me ta mbyllnin portën, rrihnin sa i copëtonin të pabindurit, pastaj i lidhnin rreth qafës), ja nië pishine. Këtu laheshin oficerët e kampit. Më kot, se duart makbethiane të kriminazist s'do të mund t'i lanin gjithë ujërat e globit. Gurorja me poshtë, një mjedis ideal për të xhiruar skena filmash të epokës së skllavërisë. Dhe diku në oborr, guri i vdekjes. Te ky gur i lidhnin ata më të rrezikshmit; pasi i zhvishnin, i linin tërë natën në 20 gradë nën zero, cipricullak, siç i ka bërë nëna, duke u hedhur pandërprerë nga një kovë me ujë akull. (ushtarët oë hidhnin këtë kovë ndërroreshin si nië pjesë e gurit: të zbardhur e të ngri-rë përgjithnjë.

Brenda në kamp, një hollësi. midis shumë të tjerave, të thërret me nië klithmë tejnjerëzore. Pranë dhomave të gazit, midis tyre dhe krematoriumit, në një si sallon, ja një trvezë dhe nië arkëzë si koritë, të dyja prej guri. Mbi këtë tryezë i shtrinin viktimat për «operacionin 2». Pas vdekjes. Xhelatët afro-

heshin me thikat vetëtuese. Ç'mund t'i bësh të vdekurit tashmë? Pas «dushit» me gaz «ciklon B» s'ka më vend për plumb as për thikë. Por ja që ka. Trupat pa jetë i shtrinin në tryezën e gjatë. Me një punë shumë të kujdesshme «artistike»(!) ua rripnin pjesët e lëkurës me tatuazh. I grumbullonin pikërisht këtu, ja, në arkën prej guri të gërryer. Kujdes, të mos dëmtohen, sadopak, mallra me vlerë speciale! Me to përgatiteshin çanta, dorashka e të tjera, dhuratë Frau X, zonjave e zonjushave të oficerëve të lartë!

Janë origjinale. mburreshin para tyre, prej lëkure njeriu safi. Ja, kjo është pikërisht pjesë e gjoksit — pjesa mbi sisën e majtë — të një 19-vjeçari. Qe i bukur, sy e flokëgësh-tenië. Siç na thoshin tanët, letrat ia dërgonte gjithmonë vetëm nënës, sepse nuk kishte arri-tur të kishte një vajzë. oë të çmallej me kujtimin e aromës së sai. Kio. . .

Dihet që edhe Mein Kampf i Hitlerit pikërisht prej lëkure të tillë i kishte kapakët!

Mendia ku nuk shkon. Në këtë varr të nërbashkët të giallësh e të vdekurish, u zhdu-kën edhe mbi 470 shqiptarë. Dhe c'diem që cenë, për besë! Në niërën nga dhomat janë ekspozuar fotografitë e 4 svresh. Xhevdet Doda. Kozma Nushi. Telat Noga, Vasil Gja-ta. . . Përpiqesh, gjithsesi, ta largosh vëmend-ien prej tyre. Se nuk dëshiron që diku, në dritën e kaltër që shkrep nga përplasia e

përfytyrimeve, të të dalë dhe portreti i njërit prej tyre, i shtrirë në tryezën e gurtë. . . Jo. E pamundur. Shporruni, mendime magjistricalash të liga!

Megjithatë ata pikërisht në këtë kamp ranë...

Do të mjaftonte zhdrynimi i shurdhmemecërisë së kësaj arke të tmerrshme, sa një çerek varri, për të shpirë ndërgjegjen një-rëzore, sado të trullorur, thua me vete. Më kujtohet Petër Vais. «Hetimi» i tij i pakryer. «Hetimi» i tij ferr. E konceptoi të strukturuar në «rrathë», sipas modelit të Komedisë Hyvinore të Dantes. Jo për manierë, po për afërinë e skenave. Asnjë fakt nuk e shpiku. As që ishte nevoja për fantazi. I mjaftoi procesi i Nvrembergut. I doli e i teproi.

Në një gjendje shpirtërore që merret me mend, pasi ke ngatërruar në fillim drejtimin e dalies, ndalon diku në miediset e iashtme, gjithnjë brenda territorit të kampit. Dhjetëra pllaka përkuitimore janë rreshtuar. Me adresë, pa adresë, me emër ose jo, nga një shtet ose nga një komb. . .

Njëra tërheq vëmendjen në mënyrë të vecantë. Ka formât më të madh, shkruar disi ndryshe.

Afrohesh. Është nënshkruar nga një grup, në emër të homoseksualëve. Nga një grup, diçka si organizatë ose shoqatë. U ku-

shtohet homoseksualëve të zhdukur në kamp.
Kaq.

Dikush kallëzon për kërkesat që ka pasur nga shumë vende, organizata etj., për të vënë disa pllaka përkushtimi, për bijtë që u tretën këtu. Por nuk u pranuan. Tani për tani s'ka më vend, s'ka ku të vihen, që përgjigjja. Ndërsa për këtë «përkushtesë», që fyen në atë shkallë personalitetin e njeriut, nga cilido vend i globit, vendi u gjet.

Demokracia borgjeze i ka këto, mendon me vete, ndërsa ndien nevojën për t'i përmbajtur disi rropullitë e barkut, zorrët, që të duket sikur mbështillen e kapërthuren me njëra-tjetrën. Ikim. Të ikim sa më parë!

Më në fund, Semmering. Tungjatjeta, Karl Gega! Vetëm një djalë si ti, me gjak malesh nëpër dej, mund të përbironte aq mjeshhtërisht nëpër labirintet e zemrës së maleve, t'i bashkonte përpikmërisht tunelet në kraharor të tyre.

Nga një obelisk disa metra i lartë, portreti i shqiptarit të madh vështron i sigurt e plot besim në vetvete. Por një e prerë mërzie, që i rrëzohet nga balli, këputet diku te mollëza. Ndoshta përfundimi tragjik që pati, pa iu gëzuar frytit të talentit të vet, si pasojë e zilisë? Nuk thonë kot që zilia t'i err sytë më keq se paraja. Rexhep Qosja, duke e shprehur diku këtë ide, citon një dijetar. Hanna Arentin, më duket.

Për këtë është si i vrarë Karl Gega, në ballë të Semmeringut? Ka të ngjarë që një hall tjetër e gërryen në këtë faqe mali. Një hall e një brengë.

Dikush që deshi t'i mohonte veprën për së gjalli, përpiket t'i mohojë dhe gjakun. Ja. Në rrokjen e parë të mbiemrit, midis G-së dhe e-së, është shtuar një h: Ghega. Një gropë e thellë në formë të shkronjës V, përpiket më tej të veçojë mbiemrin e pastër, thjesht shqiptar, Gega, me emrin e njohur e ndoshta paksa kozmopolit: Karl. Pra Karl V(on) Ghega.

Dy bashkëtingëllore të shtuara përdhunisht, bashkë me definicionet lakonike të fjalorëve enciklopedikë, që e lënë në errësirë origjinën, vështirë ta ndryshojnë sadopak thelbin shqiptar të konstruktorit të madh. Si ndodhi me Balzakun? Aq shumë pati luftuar në rininë e tij (dhe këtë e bënte vetë, me të gjallë e me dëshirë, e nuk ia impononin të tjerët, pas vdekjes), pra aq shumë që përpjekur, për të shtuar në emrin e tij një *de* aristokratike (Honoré de Balzac), diçka e ngjashme me *Von* të gjermanishtes. Ndërsa në kapakët e librave arriti ta vinte këtë *de*, përkundrazi, në brenësinë e tyre mbeti po ai thelb, mbeti thjesht Balzaku.

Tani më duket sikur Karl Gegën e kam njohur prej kohësh, e kam pasur koleg ose shok shkolle, kemi ngrënë bashkë katër viet te mensa nr. 1 e Qytetit të Studentëve. Ndiej

se si në damarë më lëviz më shpejt gjaku. Më rrjedh me vrull, gurgullon, siç dinë vetëm lumenjtë e burimet e vendlindjes sime. Më kap dalldia. Flas me zë të lartë, kërcej sa në një kënd të obeliskut në tjetrin, duke u fotografuar në të gjitha pikat e mundshme, ku të dalë profili i inxhinierit të pavdekshëm. Madje, mundësisht të lexohet edhe citati i tij, ku thotë se hekurudhat shkurtojnë largësitë, sjellin përparimin material e shpirtëror. Po kjo s'më mjafton.

— Eja!

Shoku që ka fotoaparatin më ndjek, i gatshëm të më plotësojë çdo dëshirë. Edhe ai sikur është ndezur ca. Dua të kem një pozë me tunelin e famshëm në sfond. Të dalë pamja e tij e plotë, në tërë seksionin.

Trenat e shpejtë elektrikë vijnë e shkojnë në orë e çast. Fishkëllimat, edhe ato fluturojnë mbi shpatinat si zogj. Qëndroj diku buzë trasesë. Ngre dorën dhe përshëndet. (Kur isha student, gjatë aksionit të ndërtimit të hekurudhës, kështu i përshëndetnim trenat kur kalonin.) Hë, shkripe, të shkretën! Ja, kështu, se nuk e dua për pasaportë!

Ende s'kishte shkrepur blici, kur një hekurudhar qimekuq, me uniformën karakteristike, u lëshua si egërsirë. Duke shtrirë dorën pas shpatullave të mia, zbrazi, duke thirrur e klithur, dhjetëra fjalë në gjermanisht. Pa dyshim sharje.

Instinktivisht kërceva 3-4 hapa rrufeshëm, duke iu larguar hekurudhës.

Ndërkaq nën këmbët tona u drodh toka. Një tren i shpejtë, që sapo kishte dalë nga tuneli me vrull të papërmbajtur, tani gati po humbiste midis pishave të kaltra, matanë.

— Ja, këtë ta kishe futur në kuadër, duke dalë nga tuneli. Dhe unë në cep, — i flas Bashkimit. — E fiksove apo jo?

Ai më sheh i zverdhur. Aparati, i hapur, sikur i dridhet në duar.

Kishim shpëtuar për një qime të dy!

Sesi m'u përfytyrua Mathauzeni. Diku, në mjediset e tij, nga krahu i gurores, janë vendosur dhjetëra përmendore, skulptura e basorelieve. Të madhësive e rrymave artistike të ndryshme. U kushtohet të rënëve. Ku një figurë të burgosuri që lutet, një tjetër kërkon mëshirë, ca brinjë të dala më tej. Një kompozim figurash kubike në krahun tjetër. Midis tyre — Partizani fitimtar shqiptar, vepër e njohur e Odise Paskalit. Aty populli, ka vënë poshtë e po i shtyp kokën me qytë të pushkës pushtuesit gjakatar.

— Në çdo 9 maj, sa herë vijmë, në grykën e pushkës të këtij luftëtari gjejmë një karafil. Një karafil të kuq, më kishte thënë ambasadori. Njerëzit nuk harrojnë.

Edhe kjo aventurë e vogël, që megjithatë desh më kushtoi tepër shtrenjtë, nga dëshira e ndezur për të pasur një fotografi me ty, do-

methënë me veprën tēnde që mrekulloi Evropën, le të shërbejë, ndoshta, si një karafil, si një karafil për ty, Karl Gega, bashkatdhetar i madh, bir i denjë i popullit që të dha gjakun. Karafil simbolik për gjithë djemtë e mëdhenj të kombit.

Karl, qe bukur këtu në Vjenë, por unë nesër do të iki. Nesër. . . Edhe sa orë duhen deri nesër? Edhe sa ditë?

Në kohën tēnde shpejtësitë reaktive s'qenë shpikur, por me veprën e madhe i shkurtove si askush distancat. Edhe ti ishe po ashtu larg atdheut. . .

Ti mirëmbetsh, Karl!

Të nesërmen në mëngjes kujtohem t'i them shokut që më përcillte në aeroport:

— Shiko, mos i thua kujt për atë që ndodhi dje. Se, sidoqoftë, nuk është ndonjë heroizëm të të shtypë treni në malet e Austrisë!

Qeshim.

— Mos harro të më çosh fotografitë, ore. Sa më shpejt!

1990

Korbat

Ke dalë nga Muzeu i Armëve i Vjenës, ke vizituar edhe muzeun e veglave muzikore, je harruar pas atij të arteve të bukura, ku turistë italianë, të paduruar, flasin dhjetë fjalë në sekondë, duke ndërprerë njëri-tjetrin. Ke kaluar pranë selive të organizatave ndërkombëtare, ku arkitektët kanë harxhuar një qiell me xham zeiss. Pavarësisht se përherë ngarkohesh me mbresa të reja, këto pamje janë gjithësesi të njohura. Mjafton të kujtojmë se, sa herë folësi i TV-së jep ndonjë lajm

nga ky vend, prapa shpatullave të tij, ato mbushin hapësirën e ekranit të vogël.

Por një detaj i pranishëm, thuhet në çdo orë të ditës, është disi i veçantë e të mbjell trishtim, sidomos kur shëtit i vetëm: në Vjenë ka shumë korba. Nuk e di sa e kanë vënë re të tjerët, po ky është fakt. Të paktën sa kohë qëndrova unë.

Në parkun e bukur të Belvederës lëshon syrin mbi skenën me bar, ku jepen, në natyrë, koncerte të filarmonisë ose të Operës së njo-hur. Pastaj merr pjesë fare rastësisht në gëzim-in e një çifti të ri, sipas tërë gjasave turistë, të cilët të luten t'ua shkrepësh një herë aparatin, ndërsa shtrëngohen fort pranë njëri-tjetrit. Dhe së fundi bie në mendime, duke qëndruar përballë ballkonit historik të Belvederës, prej ku, më 1955, katër ministrat e jash-tëm të Fuqive të Mëdha, pasi nënshkruan as-njanësinë e Austrisë si shtet, e shpallën atë. Kur ja, tek s'e pret, diku lart, mbi kokë, ia jep:

— Krra! Krra!

Ke parë Burg Teatrin, ku ligjëroi Moisiu i madh, në aksentin e të cilit kritikët dallo-nin një nerv të veçantë, që s'ishte as gjerman, as italian, po një puls i panjohur, që vinte nga gjak shqiptar; dhe je ngjitur pastaj në Kahlenberg — në «Kodrën e Qerosit», megjithatë flokëshumë, me një pyll të dendur, pemëgjithfarësh. Në lokalitë turistike në zemër

të tij, veshur me rroba kombëtare, kamerierët e shpejtë të shërbejnë birrë kaizer me kana. (Zotëri, edhe dy kaizer, ju lutem!) Kur përsëri: krra, krra! Tufat e tubuara, të zeza, fluturojnë poshtë reve, për t'u lëshuar mbi ara diku.

Aty afër muzgut, pas një shëtitjeje nëpër qytet, ku më kot je munduar të dallosh ndonjë fytyrë të njohur, krratë e pamëshirshme derdhin stërkala zyrtie mbi kishën e shën Stefanit, apo, njësoj, mbi spitalin e Rudolf Bamirësit, pa çarë kokën fare për trishtimin që mund të mbjellin te ti, një trishtim që rezonon me përhubjen që ndien kur je i vetëm në një qytet të madh, të huaj. Shpendë pa shend, korba kobëndjella, mallkon ashtu vetvetiu, ndërsa të duket se ke filluar të përjetosh së thelli tablonë e njohur të holandezit Van Gog, «Korbat mbi arë».

Kur ishim fëmijë, plakat na thoshin se korbat janë shenjë e keqe, ata ndjellin ligisht. Ndonjë vrasje a vdekje shkretuese, aksident, uri masive a epidemi e, kushedi, edhe luftë, mundet. Kur shfaqeshin ato, njëlloj sikur he-tohej pararoja e një pushtuesi të zi. Ndaj, ashtu siç na kishin mësuar, sa herë i dëgjonim, dilnim në ndonjë breg e i ndiqnim me sy, duke thirrur në numrin njëjës, sikur të donim t'i drejtoheshim seicilit veç e veç, t'i lanim hesapet pa shpëtuar asnjeri:

*Krrak-krrak-krrak,
hangsh kryet tat,
bafsh mish e gjak!*

Me tri vargje të thjeshta uronim që ato të gëzoheshin e të këndonin në gostinë makabre, ku t'u shërbeheshin kokat e tyre të prera. Dhe iknim të qetë se e bëmë detyrën. Por edhe disi kureshtarë: a ishte e mundur të zinte aq mirë vend mallkimi ynë, sa asgjë e hidhur të mos ndodhte në trevën tonë? I lodhur tej mase me helm e me plagë të shpirtit, me anë të këtij ritthi populli përpiqej të sajonte një «pritë», ashtu siç ngrinte prita buzë arave për të parandaluar turrin e mundshëm të rrebesheve. Një lloj paraprite ku, të paktën, një shpresë jo fort e argumentuar, por përsëri një shpresë, një besim, mund të mbështetej, sado i vagullt të ishte. Ne fëmijët ishim kori i këtij teatri tragjik, kori që dëbonte forcat e errëta, erinitë, korbat.

Shikon në të majtë e në të djathtë. Konstruktet kështjellore të stilit gotik sikur duan të të rikujtojnë: këtu ka qenë perandoria. Krra-krra! Edgar Poe. Përkthimi mjeshtëror i Nolit. Këto klithma mos janë sfida e fundit që u bëhet ish-perandorive, vajtimi anakronik mbi gropën e tyre? Njerëzimi është zgjuar, kjo fjalë u tingëllon demode: pe-ra-ndo-ri/ pe-ra-ndo-ri!

Ke lënë pas Jacquingasse-n (Zhakinga-

se-n), ke pritur dritën jeshile sa të marrë frymë trafiku turfollues, dhe je ulur në një nga stolat e parkut, ku zakonisht lozin fëmijët e emigrantëve turq ose arabë. Një burrë i pjekur, ndoshta rreth të 60-ve, shtyn ngadalë një karrocë.

Një bebe? Jo. Në atë karrocë, gati sa një bebe, rri e mbledhur një plakë e vogël, e imët e imët, dhe vetëm dy sy, edhe ata krejt të vegjël, i lëvizin në gjysmëterr me një gjallëri të jashtëzakonshme. E ke parë dhe net të tjera.

Ndalojnë pranë një shtërvani dhe grua-ja sa një grusht përtërihet përballë floknaiës së ujit, rreth së cilës lëvizin qetë pata, pëllumba, zogi të tierë të familiarizuar aq shumë me njerëzit, që u hedhin atyre biskota e ndonjë ushqim tjetër, çfarë t'u ndodhet. Gruaja e mbledhur në karrocë lumturohet. Ngazëllimi, ndoshta më i fortë, shprehet në shtë e burrit, që ia zëvendësoi aq ngrohtë këmbët e ia vrau ulokërinë duke e shëtitur mbi katër rrota. Dic i pëshpërit vazhdimisht me zë të ulët. Nënë e ka? Motër? Grua? Mundet. moshë e saj nuk merret vesh, po c'rëndësi ka. Ata kënaqen të dy dhe, pa asnjë bujë, dëshmojnë epërsinë e të qenit njeri. Njeriu s'mund ta tradhtojë kurrsesi racën e vet, me gjithë shëmtimet e shformimet e jashtëzakonshme që i imponon trysnia e parasë, flet me vete duke i parë.

Ke dëshirë t'u afrohesh, t'u thuash disa fjalë, t'i përqafosh. Dy njerëz të thjeshtë, shpirtin e të cilëve s'e ka grryer dot krrokama e korbit kapital.

Se ka mënyra e mënyra gërryerjeje.

Dhjetëra hapa më tutje është një kënd. Pak i mënjanuar, në park. Pak i harruar. Shatërvan nuk ka, pëllumbat nuk ulen aty. Në vend të tyre — flokët e çngjyrosur të një grumbulli thujse të përhershëm djemsh dhe, me ta, pak vajza. Pak më tutje janë ndezur llambat, midis fletëve. Po sa para bën? Sytë e tyre janë të perënduar. Dhe janë aq të rinj. Dhe kanë qenë (oh, kanë qenë!) aq të bukur. Ngushëllojnë aty njëri-tjetrin. Fundosin njëri-tjetrin. Thellë e më thellë.

Në fjalorin e banorëve rrotull ky quhet këndi i të droguarve. Ikë, ç't'u thuash. Krra-krra!

Më vjen ndër mend një njoftim i transmetuar mbrëmë në televizion. Esterraih Televizion. Pesëmbëdhjetë djem e vajza adoleshentë të një shkolle të mesme, (ku qe, në Salzburg apo në Grac? S'më kujtohet mirë si e tha), u identifikuan me AIDS. E kishin marrë virusin të gjithë njëherësh. Njëri syresh kishte gjetur diku një shiringë, kishin zënë një qoshe në pushim, larg syrit të mësuesve, (siç zinin disa nga shokët tanë në gjimnaz kur pinin cigare), dhe kishin injektuar drogë. Po shiringa paskësh qenë me HIV.

Virus HIV, V-V-Vdekje. Korbat, që i nxin aq shumë Van Gogu mbi arën me grurë, përpara se të derdheshin aty nga qielli, kishin ngulur sqepat diku në aortën e tij, çukitnin egërsisht sytë, nervat dhe zemrën, kishin zënë qiellin e botës së shpirtit të njeriut. Korbat që u derdhën nga ara mbi pëlhurë qenë vetëm iluzion. Ha-HIV!

I përfshirë në vorbullën kulturore të qytetit, harron këto pamje që ta çojnë humorin në fund të këmbëve. Por ja, të nesërmen pasdite, në një kryqëzim të rrugëve të tramvajit, shikon një çift. Rrinë si të ngulur aty. Djali është i gjatë, zeshkan. Ku e kam parë? Me siguri ndonjë nga emigrantët turko-arabë; nga ata që ndeshen në çdo cep e të ndjekin pas duke thirrur gati me dëshpërim: zotëri, urdhëroni gazetën, Vienner Caitung, zotëri, Vienner. . . Ose ndoshta pikërisht ky po shiste lule parmbremë në Pratër, ku zotërinjtë që qerasnin zonjat ose zonjushat blerjen e një tufe me zambakë e kanë në menynë e darkës. Nuk të kujtohet që, kur dikush nga ne i dha një çikë muhabet, ai pa një pa dy u ul në tryezë e zgjati dorën mbi pjatë pa e ftuar? Varfëria, pasiguria, rruga pa krye e emigrantit, depersonalizon si asgjë tjetër.

Djali rri si i ngrirë, duarlëshuar. Fytyrë për fytyrë me të është vajza, e hollë dhe e gjelbër, krejt si fije bari. Flokët e drejtë, ngjyrë limoní të çelur, i lëshohen mbi shpatulla.

Duket, është vendase kjo. Vajza ngrihet në majë të këmbëve e përpiqet më kot ta puthë në buzë: ai është i gjatë, s'e arrin dot. Ai është i mpirë. Nuk përkulet. Bota tek ai në këto çaste ka vetëm një përmasë: gjatësinë.

Ajo lëshohet e dëshpëruar, me kokën varur, pret të rimbledhë forcat e të ngrihet prapër në majë të këmbëve.

Duket sheshit dora e po atij regjisori të njohur të kësaj skene të përçudnuar, të këtij spektakli absurd: droga.

Njerëzit hipin në tramvaj e shkojnë në punë të tyre pa i vënë re (sa ka të tillë!). Por edhe ata që rrinë si dy parmakë të ngulur keq, gati për t'u rrëzuar e për të bllokuar shinat, nuk dinë të shohin asgjë. Sytë e tyre: dritëpërthithur, si të ngrënë. Sytë...

Krra-krra!

*O ju korba, që më hani,
sytë e zez mos m'i ngani...*

Edhe këtë radhë ishin korbat vërtet, apo thjesht m'u krijua përshtypja?

(O ju droga që më hani,
sytë e zez.)

Vonë kthehem nga qyteti Melk, ku është hapur sezoni i shfaqjeve verore të teatrit në natyrë. Kemi ndjekur aty pjesën e njohur të

Shekspirit «Zbutja e kryeneçes». Me të u çel veprimtaria. Shikuesit janë ulur në një amfiteatër druri, rrotullues, midis pemësh të larta plot gjelbërim. Mendjen e ke te shfaqja, te loja realiste, me elemente natyraliste e akto-reve. (por pa manierat moderniste, të cilat, në vende të tjera, i ka vuajtur me dhimbje mbinjerëzore edhe Shekspiri i madh). Qesh me batutën e hollë, kur dy aktorë, pasi janë zënë e ngrënë, tërhiqen në një qosh e thonë në intimitet: «A nuk bëjmë edhe ne si politikanët? Zihen e grihen, por, kur vjen puna për të ngrënë, i shtrohen tryezës si miq të vjetër!»

Krra-krra!

Përsëri. iu, zogj të zinj!

Më kujtohet një fabul që diku e kam dëgjuar. Nieriu punonte në qytet dhe, njëkohësisht me të, nga shtëpia në punë, fluturonte çdo ditë një korb. I heshtur, por tepër i përpiktë në itinerarin e tij, paralel me njeriun. Një ditë, kur hyri një miegull e rëndë e mbuloi pemë e udhë e nieriu s'u pa më, ia dha një klithmë: krra! Aq e dhimbshme dhe e fortë ishte këtë radhë, sa që u duk se nuk doli nga ai kraharor i prapë mbuluar me pendë-qymyr, por dicka e madhe, ndoshta vetë toka a qielli, pëlcitën e u çanë më dysh, kataklizma!

Duke mos mundur ta dallonte më njeriun, për shkak të mjegullës, korbi pandehur **se ky i fundit kishte fluturuar dhe tashmë**

toka e qielli do të zotëroheshin përfundimisht prej atij, njeriut. Ndaj lëshoi atë krrakanë-grahmë me dëshpërim mortar.

Kjo ishte fabula. Apo e vërteta? E sotmja apo e nesërmja?

Bëjmë një shëtije buzë Danubit dhe ngjitemi të pimë një kafe atje lart, në kullën e TV-së, ku Vjena soditet mrekullisht, si nga dritarja e avionit ose, po deshe, si nga ajo reja e bardhë që krijohet në qiell.

1990

Natë e butë jugore

Në Patra, ndonëse gjithnjë me makinë, do të hynim në mënyrë të pazakontë: nëpërmjet ujit. Do të kalonim me traget ngushticën, ku një rrip i kaltër përshkon belin e hollë të tokës greke dhe bashkon dy dete të mëdha: Egjeun me Jonin.

Në fillim as që të shkon ndër mend të arsyetosh për vlerën ose përmasat e kanalit. Është ora tre pas mesnate, gjumin s'e ke vrarë fare e, për më tepër, ke hall sa të zësh një vend të përshtatshëm për makinën, në një cep të ferribotit, midis morisë së dhjetëra e

dhjetëra automjeteve të përmasave e llojeve nga më të ndryshmet. Pa folur për fytyrat e gjithfarëshme që sheh rrotull. Pastaj kujdes paratë, që të paguash taksën: në dollarë i ke apo në dhrahmi?

Ndërkohë dikush tregon se, kur çohet erë e madhe, megjithëse largësia midis dy brigjeve është e shkurtër — përshkohet për 15-20 minuta — trageti përsëri nuk niset. Turbull më vjen ndër mend njoftimi që e dhanë para disa kohësh pothuajse të gjitha agjencitë e lajmeve të Evropës për mbytjen e një trageti të tillë diku në La Mansh, pak minuta pasi ishte nisur. U fundos duke filluar nga bishti e mbeti i ngulur vertikalisht në rërë, në terrin e trashë milionavjeçar të ujërave. Viktimat — gra, fëmijë, çifte të porsamartuara. Gjëra që ndodhin.

Nga kreu i një shkalle ku kemi qëndruar tërheq vëmendjen një karvan i vogël, krejt origjinal, që, ashtu pa u shkëputur, ka zënë një rrugicë vend midis autoparkut lundrues. Në krye është një kamion i tonazhit të vogël, diçka më i madh se një «Zuk». E pasojnë nja 3-4 vetura të vjetra, të vogla, të zbuluara. Në kamion, pa kurrfarë rregulli, janë hedhur dyshekë e mbulesa të ndryshme të palosura ose të zhubrosura, shilte, enë kuzhine, një radiokasetafon i madh që s'e dallon dot i ç'marke është, violina, dajre dhe tri dhi fort të bindura, që as u shkon mendja të lëvizin

që andej. Pranë tyre rri një qen i madh, i zi. Shikimi i dyshimtë i tij përjashton çdo mundësi kompromisi. Njerëzit kanë zbritur, me sa duket.

Ca arixhinj të thatë e mustaqemëdhenj vijnë vërdallë, bisedojnë me gratë, u sjellin ndonjë gjë për të ngrënë fëmijëve, që kërthijohen e s'duan t'ia dinë për gjumin. Nuk është e vështirë për ta kuptuar që këta janë zotërit e këtij karvani ekzotik. Pa dyshim gjëja më tërheqëse midis veturave luksoze të turistëve perëndimorë, që ushqejnë dobësinë e njohur për qytetërimin e lashtë helen.

Një ekzaminim disi më i imët i karvanit e vërteton plotësisht hamendjen e mësipërme. Turiri i makinave është i stolisur me vargje të shumta unazash të madhësive e ngjyrave të ndryshme, ku shquhen nuancat e së verdhës e së portokallisë. Dhe, më e bukura, shih kamionin e parë: midis rruazash është varur një zile e madhe, turivarur ngaqë s'e tund kush, mjaft e rëndë. Doemos, ai është përçori!

— Arixhinjtë po arixhinj, kudo njësoj, — i them pa e fshehur buzëqeshjen një burri të thinjur, fytyrëzbardhur, që qëndron në anën tjetër të tryezës dhe, si të jetë vajzë gjimnazi, lëpin më nge një akullore. Ka veshur një bluzë të trikotuar, në ngjyrë «pa ngjyrë». Diçka si kaki e shpëlarë.

Edhe ai ndoshta një gjë të përfaqshme po mendonte. Pasi tund kokën me buzëqeshje

mirëkuptimi, nis të këndojë vargun e një kënge të njohur të Mirej Matjesë: *C'est ta vie cigano...*

Kjo këngëtare sot sikur s'është dhe aq në modë, mendova. Po moda shkon e vjen, vlerat mbeten.

Më thotë se është profesor nga Kanada-ja. Nuk është turist. Është anëtar i një organizate ekologjike-pacifiste (ose ai s'më sqaroi fort mirë, ose unë s'e kuptova si duhet), që propagandon masat për të parandaluar rrezikun bërthamor. I pari, thotë, rreziku nga lufta, (këtu mbase diç po bëhet). Por edhe nga centralet atomike nuk është më i vogël. Çernobyli, pesë miliardë dollarë u kushtoi rusëve, d.m.th. Bashkimit Sovjetik. . .

Ligjërata iu këput në mes. Një lëmsh i zi i kërleshur, se nga ka kërcyer dhe pup, hungërron te këmbët tona.

— Çyp, të marrtë dreqi, — shan vende, i trembur, Qemali. Pastaj shfajësohet.

Qeni leshtor, që u hodh nga karrocERIA e makinës, ku rrinte bashkë me dhitë, tani lëpin tërë dashuri duart e një gruaje të re, ngjitur me ne. Ajo seç i thotë disa fjalë gabelisht dhe kafsha hidhet e qetësohet.

Ndërkaq gruaja ngre si me përtesë qerpikët e rëndë dhe zbulon një palë sy që rrallë mund t'i ndeshësh. Krejt të gjelbër, të gjelbër si një gjol, nën shelgjet lotuese të qerpikëve.

Të lëngëzuar e të ndritshëm, të ëmbël e turbullues, ëndërrimtarë e joshës, si ata.

Nuk qenka grua, po një vajzë e shumta 17-18-vjeçare. E sigurt dhe e gjithëpushtetshme për bukurinë e saj, sheh në të majtë e në të djathtë. Është e qartë, këtë e bën kryesisht për t'u tërhequr vëmendjen njerëzve rrotull. Herë pas here i hedhin ndonjë romuz, që bën t'i ndizet një vetëtimë e verdhë në të blertë diku mbi mollëza, e në të njëjtën kohë përgjigjen e ka në majë të gjuhës. Duket që s'rron dot pa shigjetat e shikimeve të simpatizantëve, qofshin dhe krejt të rastit. Dhe ndoshta më e fyer dhe e vetmuar se kurrë ndihet kur dikush i kalon anash, aq më keq, i rri pranë, pa i kushtuar vëmendjen më të vogël. Hileqarkë, e morëm vesh trukun tënd. Prandaj e thirre qenin, që të na zgjoje, që të të shihnim e të të ndienim se je e pranishme e të kemi pranë!

Vazhdonte të merrej me qenushin e saj. Ndonjëherë ngrinte sytë, duke parë, diku prapa nesh, sikur priste ardhjen e dikujt. Tani ia mësuam shejtanllëqet: edhe donte të shtihej mospërfillëse, edhe ia kishte ënda të na trondiste.

M'u kujtuan vargjet e një kënge të vjetër:

*Moj e mirë, synin larush,
ty ta vrafsha qenin pushkë,*

*ty ta vrafsha atë qen të zi,
qesh një natë, s'më la me hy!*

Kushedi ç'vajze me faqe që i pëlçisnin prej ujit të borës e tamlit të dhenve i ishte kushtuar kjo lirikë e egër shpërthyesë. Ndërsa unë po ia këndoja në heshtje një kokete lëkurëpjekur si në pikturat e Gogenit, një gabelice endacake në ujërat e Jon-Egjeut!

Si për sfidë, vajza u ul në karrige, në cepin tjetër të tryezës sonë. Qeni i kërcente sytë sa te njëri te tjetri, duke mosditur ende ç'qëndrim të mbante me ne: dashamirës a mosbesues.

— Nga Shqipëria? — hyn në bisedë vajza pa kurrfarë druajtjeje, — kemi ca kushërinj atje.

Kushërinj keni edhe në fund të botës, prapa diellit, më erdhi në majë të gjuhës, po natyrisht s'ia thashë. Ndërkaq profesori, si me një telepati të beftë, i dha pikërisht atë përgjigje që po mendoja se s'ishte keq t'ia thoshte dikush.

— Kushërinj mbase, po kushërira kaq të bukura zor se keni gjëkund.

Qerpikët me rrema kërcyen. Me dy vetëtima të gjelbra gjuajtën mollëzat e përhënura.

Zotëroi një heshtje e shkurtër, e mjaftueshme, që kanadezi t'i kthehej bisedës pikë-

risht aty ku e pati lënë me një kujtesë fort të kthjellët.

— Pra, pesë miliardë dollarë u kushtoi Çernobyli rusëve. Por as pesëdhjetë miliardë nuk mund t'i bëjnë të paqena ato pasoja fatale në jetën e njerëzve aty. Tri kategori e kanë pësuar. Të vdekurit po, se vdiqën. Të gjallët, merret me mend, se ata po i heqin. Por edhe të palindurit, edhe ata, edhe ata.

Profesori goditi tryezën me nyjën e gishtit të mesit.

— Se ja, — vazhdoi, — mund të flasësh për anomali kongjenitale, raste të kancerit (leucemi, sidomos), devijime të kromozomeve apo ndryshime të proteinës së gjakut.

Mori frymë thellë dhe e drejtoi trupin. Kishte shpatulla të gjera dhe të jepte përshtypjen e një njeriu me energji që s'i shteronin lehtë.

— Të kujtohet tabloja e Pikasosë, për Hiroshimën? Ç'dhimbje njerëzore, ç'tragjedi ka mundur të derdhë, e çuditshme, në dy pëllëmbë pëlhurë! Dhe nuk është fantazi. Një mbushje. . .

Çudia ndodhi tani, kur zeshkania e bukur, me një lëvizje sa të çiltër aq edhe nazike, ia vuri dorën në gju shkencëtarit, duke e detyruar, në këtë mënyrë, pa kurrfarë politese, ta ndërpriste ligjërimin në një nga kulmet e tij.

— Po këtu në Greqi, ka atom?

Formulimi naiv i pyetjes dhe vetëtimbrë dëshmonin qartë se kishe të bëje me një fëmijë.

— Thonë që ka në bazat amerikane, — vazhdoi. — A do t'i heqin vallë?

M'u kujtua se, që nga Janina, ku ne kishim kaluar në orën njëmbëdhjetë pa pesë minuta, në muret e Kalasë së Aliut, nëpër vitrina, në ballina ndërtesash, nëpër të gjitha qytetet e vogla, (apo qendra fshatrash), ku ne u ndalëm për t'u flladitur me ndonjë gjë ose thjesht për të parë, gati në çdo vend, një numër i pafund pllakatash i bënin jehonë kush *Pasokut* e kush *Demokracisë së Re*. Qe maj 1989, periudhë zgjedhjesh. Portretet e dy liderëve kundërshtarë shquheshin kudo, ndonjëherë edhe të vendosura njëri mbi tjetrin.

Profesori që, ashtu si dhe unë, s'e kishte pritur një ndërhyrje të tillë, s'e mblodhi menjëherë veten.

Prapë na hapi punë, shejtanla. E ku ta dimë ne do t'i hiqni a s'do t'i hiqni bazat e huaja! Të kesh t'u thuash këtë e vendosni vetë ju, grekët, puna juaj është. Sa për ne, ne s'ke-mi as dhe një kapsollë në truallin tonë.

Natyrisht një replikë e tillë do të ishte më e pagdhendura, më shabllonja, për të mos thënë më idiotja, ndër gjithë variantet e përgjigjeve të mundshme. Risolla ndër mend shprehjen që pata përdorur pak më parë, në

bisedë me kanadezin, arixhinjtë po arixhinj janë, dhe i bëra një ndreqje të vogël. Në vend të fjalës arixhi vura: njeri. E po njerëzit njerëz janë. Pavarësisht nga ngjyra, nga raca, nga niveli kulturor ose intelektual, të rinj ose të moshuar, të bukur ose më pak të bukur, kanë disa halle të përbashkëta, i shqetëson fati i përbashkët i njerëzimit, duan të rrojnë në paqe, në qetësi e mirëkuptim. Mbase ti cigankë me flokët e pakrehur, sterr të zez (nata e butë e detit të jugut i zbut me një dritë të kaltër), lëshuar të tëra në kraharor shkujdesërisht, kur fole për kushërinjtë në Shqipëri, kjo ishte thjesht një teke bukurosheje të llastuar, apo më shumë se kaq, dëshira për të hapur muhabet me dy banorë të shtetit fqinj, me dy shqiptarë?

Edhe njëra, edhe tjetra, besoj.

Një zile tingëlloi fort. Ferribati kishte ndaluar dhe makina e ballit të karvanit. me njëqind lloje rruazash e xhingla-mingla e zilen e rëndë në qafë, kishte ndezur motorin për të zbritur në bregun tjetër.

Tring-tring!

1990

I treti te Muhamet Aliu

Në aeroportin e Kajros e filluam me një keqkuptim të lehtë. Po ky keqkuptim luajti rolin e një mrekullie të vogël.

Kush ka fluturuar, qoftë edhe tranzit, nëpër aeroportin e ri të këtij qyteti, ose edhe nëpër të vjetrin, ka vënë re se në çdo orë të natës, të ditës po që po, është e pranishme tollovia e pafund e udhëtarëve, për të mos thënë rrëmuja. Mbase sepse është një pikë kyçe, ku kryqëzohen thuajse të gjitha linjat ajrore me botën arabe dhe gati krejt Afrikën.

e Zezë. Turistë dhe sipërmarrës gjithfarësh, studiues të xhunglës ose të punësuar në Arabinë Saudite shkojnë e vijnë paprerë. Pastaj sheikë e gjysmësheikë të naftës. Bien në sy sidomos gratë e bukura të tyre, flokë-e qerpi-kërënda, me buzët e plota si hurma arabie, me vëthë e varëse të mëdha floriri 24-karatëshe, që u rrutullohen nëpër gjokset e hapura, si hënëza shkretëtire përreth oazeve. Dhe fëmijët rrumbullakë, që lozin me lodra e zinxhirë të vegjël palë-palë vezullues si valëza, sepse edhe ata janë prej ari të kulluar.

Midis kësaj zallamahie nuk mungojnë edhe njerëz të dyshimtë, spiunë, terroristë të maskuar. Ndoshta për këtë arsye disa herë kontrollet janë shumë të rrepta e skrupuloze, gjë e natyrshme për çdo aeroport ndërkombëtar, aq më tepër për një aeroport që funksionon në një kryqëzim strategjik si ky, ku avionët ulen e ngrihen kaq dendur e natyrshëm, si zogjtë.

Duke dashur të mos vonohemi me formalitete që në rastin tonë janë krejt të kota. nxjerrim pasaportat, tregojmë edhe çantat me vulë diplomatike. Për të përforcuar sigurinë që me ne s'do të kenë asnjë problem, në të njëjtën kohë shqiptojmë:

— Albania.

Nëpunësi ngre sytë, i kalon vetëtimthi mbi ngjyrat e çelura të flokëve e syve tanë, që gjithsesi spikaftin më shumë në atë sfond

fytyrash të zeshkëta ose krejt të zeza. Pastaj, si për t'u siguruar, përsërit me një intonacion jo aq pyetës, sesa dëftor:

— Alemania.

Është keqkuptuar.

— Jo Alemania, — sqarojmë, — Albania, Al-ba-nia. Muhamet Ali.

— Aa, Muhamet Ali, Albania, jes, jes elham dyrylah. Urdhëroni, urdhëroni, kaloni!

Sytë e zez e të mëdhenj të nëpunësit ngrohen nga një dritë miqësore, tiparet e fytyrës, deri atëherë të prera e krejt të palëvizshme, që paralajmëronin asnjë kompromis në detyrë, çlirohen menjëherë, duke shprehur një qetësim shpirtëror. Si «me urdhër të peshkut» kemi marrë statusin e miqve të nderuar. «Shkëmbi» u ça. Në vend të «hapu Sezam» kemi shqiptuar thiesht emrin e Mehmet Aliut të Misirit, sic njihet në vendin tonë, vecse jo në variantin fonetik turk, por arab. Pra Muhamet.

Emri i themeluesit të Egjiptit modern, ç'është e vërteta, luaiti rol të dyfishtë.

Nga njëra anë ndihmoi në një identifikim të meniëhershëm të kombësisë sonë, çka ishte e mjaftueshme që të lehtësohen formalitetet, sepse të gjithë e dinë se asnjë qytetar shqiptar nuk paraqit rrezik si terrorist, kontrabandist droge, trafikant armësh ose diçka tjetër e ngjashme. Po ky emër shërbeu një-

kohësisht për të zbuluar para nesh rrezatimin e pavenitur të figurës së tij, nderimin e jash-tëzakonshëm që Muhamet Aliu gëzon edhe sot e kësaj dite, pas një shekulli e gjysmë, në shtetin më të madh arab. Reformator i administratës, ekonomisë e ushtrisë, ai nacionalizoi tokat e punueshme, përmirësoi në mënyrë rrënjësore rrjetin rrugor dhe ujitës, kultivoi për herë të parë bimë të tilla industriale, si pambuku e kallami i sheqerit, i dha zhvillim industrisë e modernizoi sistemin arsimor. . . Me pak fjalë, Muhamet Aliu njihet si nismëtar i zgjimit kombëtar dhe paraardhës i rilindjes arabe (al — Nahdá).

Këto i radhit në kujtesë si në një fjalë rasti.

Më pas do t'i ndeshim kudo gjurmët e tij. Ismailia, Port-Said. . . qytete me histori që i kalojnë kufijtë e vendit të vet, kanë marrë emrat e bijve ose nipërve të shqiptarit të njohur. Disi një ndjenjë jo fort të këndshme përjetojmë kur kujtojmë se edhe Faruku, mbreti i fundit i Egjiptit, që sundoi deri në vitet '50 të shekullit tonë e mjerisht nuk shquhet për ndonjë nam të mirë, ka qenë gjithashtu nip i Muhamet Aliut, pinjoli i fundit e dinastisë së tij. Po ky fakt s'na prish ndonjë punë, vetëm sa shërben për ta ekuilibruar sadopak entuziazmin. Se, kuptohet, ky nuk mund ta ngarkojë me kurrfarë përgjegjësie ose ta errësojë sadopak stërggjyshin e tij të

lavdishëm. Mbretërit do të qeverisin si mbretër, gjithsesi. Dhe në shekullin e 20-të farukët s'kish si të mos ishin anakronikë.

Në këto rrethana ishte e kuptueshme të na shtohet vendosmëria, që ndër pikat e para në programin tonë të vizitave private, të përcaktuara e të realizuara me shokët e ambasadës, krahas piramidave, do të ishte pa dyshim xhamia e Muhamet Aliut. Impozante, mbi një kodër-kështjellë, të thërret e të vret me bukurinë e madhështinë. Sa mospërfillëse, aq joshëse, njihet si një ndër veprat më në zë të arkitekturës islamike të këtij qyteti zhurmëmadh, i cili, në fund të fundit, më shumë se kujtdo tjetër, mbijetesën e tij ia detyron Nilit. Sepse në Kajro s'bie kurrë një pikë shi, dhe për këtë arsye ndërtesat, rrugët, lulishetet, duken si të lyera me një bojë pluhurore, bezhë në të përhimtë. Nili e përshkon qytetin e degëzohet nëpër të, ndahet e prapë bashkohet në një ripajtim të degëve të veta, duke krijuar ishuj lumorë të banuar prej. . . mbi një milion vetash, siç është për shembull Zameleku, në të cilin ndodhet edhe ndërtesa e misionit tonë diplomatik.

Trafiku i potershëm, tepër i ngarkuar, bën që të vonohemi tej llogarive tona dhe në oborr të xhamisë mbërrijmë kur orari i vizitave po i afrohej fundit. «Çelësi» gjendet vetëm kur, midis mizërisë së turistëve, arrijmë t'i shpjegojmë punonjësit të ngarkuar si

punë portieri se nuk ishim thjesht amatorë kureshtarë ose turistë rutine, po zotëria ishte pikërisht «safiri» (ambasadori) shqiptar me miqtë e tij nga Tirana. Kaq u desh që mreku-llia e aeroportit të përsëritej. Dritat jeshile u hapën gjithandej. Ciceroni, që e thërresin Ahmet, megjithëse në fund të një dite mjaft të lodhshme, është tepër i sjellshëm.

— Ja, kubeja, — thotë, — është e lartë...

Ndërsa përpiqemi të gjejmë një objekt krahasues për lartësinë, ndërhyjnë me padurim shoferi i ambasadës, një sanguin tipik:

— Mos e zgjatni, — thotë, — jua shpjegoj unë. Nga këtu, në majë të kubesë, është sa 15-katëshi ynë në Tiranë, ndoshta ndonjë kat më shumë.

— Në këtë pjesë. — Ahmeti ngre gishtin tregues, kur të gjithë ne kemi ngritur shikimin përpietë, — është harxhuar një tonë ar, vetëm në këtë krah...

— Sa ton na mban neve Anglia? Dy tonë. — vazhdon sanguini ynë i dashur, i specializuar, ndoshta, duke shoqëruar edhe herë të tiera delegacionet e rralla shqiptare që vij-në këtu, por më e mundshme është nga sensi praktik e temperamentit i tij.

Si nuk ka një guidë të shkruar, them me vete, një fletëpalosje. Ia kërkoj Ahmetit.

— Malesh!

Thotë një fjalë të papërkthyeshme në

shqip, gati një lloj pasthirrme, që përdoret kur do të thuash afërsisht: ç'e çan kokën, mos i vë rëndësi kësaj pune. Dhe vazhdon të tregojë altarin prej druri (sa një ndërtesë pesëkatëshe, plotëson shoferi), për të cilin nuk është përdorur asnjë gozhdë, asnjë pjesë metalike. Gjithçka është e gojuar, duke i mbërthyer gojë më gojë pjesët e drunjta të gdhendura mjeshhtërisht.

Të gjitha këto Ahmeti i kalon me shpejtësi. Madje edhe përgjigjet e dy-tri pyetjeve tona i thjeshton me ndonjë frazë të shkurtër, plus «malesh». Mos filloi të veprojë lodhja, mendoj. Si nuk shesin ndonjë guidë, dreqi e mori, më fekon në mend për të dytën herë.

Por jo. Ahmeti paska një plan të fshehtë. Dhe dëshiron të ketë në dispozicion kohën për ta përmbushur.

— Tani, meqë jeni shqiptarë, do t'ju bëj një privilegj, që e rezervojmë vetëm për personalitetet tepër të nderuara, — thotë i gjallëruar e me një ton solemn. — Do t'ju shoqëroj nëpër mjediset intime e familjare të Muhamet Aliut. Kjo vetëm për ju.

Ahmeti, i shkujdesur e gati i çinteresuuar pak më parë, ka marrë pamje serioze. Ngjan si diplomat.

Pasi sqaron, jo pa vështirësi, në arabisht, dy-tre persona që duan të na ndalojnë në korridoret ku na prin, (kjo na bind edhe një herë për privilegjin që po na bëhet), na udhëheq

në dhomën e fjetjes. Si të gjitha dhomat e mbretërve, ç'e zgjat. Pastaj, me një hap të kujdesshëm, na nxjerr në një sallë më të gjerrë, gjysmë të ndriçuar.

Për një çast shtangemi: një burrë i thyer në moshë rri këmbë-kryq mbi një shilte dhe, përballë tij, tre të tjerë, në këmbë, marrin e japin me të. S'e dinim që këtu kishte njerëz! Ç'ka kurdisur ky shejtan Ahmet?

— Ja edhe Muhamet Aliu, — thotë, duke u dhënë shpatullave, paksa mbrapa i lehtësuar.

Duket sikur na ka prirë në mbretërinë e Hadit! Ç'dreqin je ti, dervish — Ahmet: plakku Karont, Qerosi që zbret në «dynjanë e poshtme» në krah të shqiponjës, a një speleolog zemërgur i vdekjes?

Vijmë në vete dhe e kuptojmë që këta janë thjesht manekinë. Po një imitacion i përkryer i portretit të tij. Vallë janë mbështetur te punimi i njohur i Couder, ekspozuar në Versajë?

Qëndrojmë duke vëzhguar me vëmendje. Heshtja bëhet më e pranishme, më e thellë. Më duket sikur dëgjoj zërat e atëherëshëm, fjalën e ngadaltë, të peshuar, për shkak të moshës, por edhe të përgjegjësisë së madhe që kishte një burrë shteti si ky.

— Është salla e pritjes së popullit, — shpjegon Ahmeti. — Këta të dy në këmbë janë felahë. Dallohen menjëherë nga veshja.

Po i ankohen për tokat. Ai i dëgjon me urtësi dhe jep zgjidhjen e duhur. Kështu ka qenë Ai. U zgjidhte hallet njerëzve.

Ndihet qartë simpatia e Ahmetit. Një respekt krejt njerëzor, jo fetar. Hesht përsëri. Ndoshta dëshiron të na lërë kohë edhe neve të merremi me mendimet e përfytyrimet tona. Ndoshta është disi i prekur edhe vetë. Ndoshta. . .

Më shkrepet t'i bëj një pyetje.

— Po ky i treti, ç'është? — Rri pranë felahëve, në këmbë si ata, por ka tjetër veshje. Më ngjan si qytetar...

Ahmeti e drejton trupin, duke përsëritur lëvizjen e njohur të shpatullave, dhe s'e fsheh dot shqetësimin që i shkakton pyetja. Mrrolet në fytyrë, rri si në mëdyshje, sikur përtypet, i pavendosur ç'përgjigje do të japë. Sekondat duken minuta. Nuk arrij ta kuptoj pozitën e vështirë, në të cilën duket qartë që e vura me pyetjen time.

— Ky i treti është . . . përkthyesi, — thotë, duke dalë disi nga ajo gjendje turbullimi. — Është pikërisht përkthyesi, po, po. Duhet kuptuar realisht gjendja. Këtu Muhamet Aliu është në një moshë të thellë. I ka lënë të tetëdhjetat. Dhe. . . sikur e ka të vështirë të flasë arabisht. E ka më të lehtë... gjuhën e nënës, të më kuptoni, është në moshë shumë të thyer, vitet kanë bërë të vetën, do parë realisht, domethënë. . .

Fraza i mbështillet nëpër gojë, si një çamçakëz, që as e përtyp, as e hedh dot.

— Domethënë ky përkthen nga arabishtja në... në shqip. Dhe anasjelltas.

Pasi ka shqiptuar këtë frazë të mundimshme, Ahmeti merr frymë i lehtësuar. E hoqi sikletin. Sikur shkarkon një barrë të rëndë nga supet. Një forcë e padukshme bën që turbullimi nga ai të përçohet te ne.

Gjysmë shekulli kishte punuar e luftuar këtu, kishte udhëhequr me sukses të plotë këtë vend të madh e të vështirë, duke e nxjerrë nga prapambetja e thellë. Por shqipen nuk e harroi! Përkundrazi e mbajti si gjuhë të parë, ndoshta më të dashurën e më të sigurtën. Gjuhën e nënës.

Një befasi e vërtetë e shungulluese për ne!

Përpiqem të përfytyroj si ka tingëlluar gjuha shqipe në këtë mjedis, në gojën e atij burri krejt mustaqebardhë e trupvogël, tashmë të rrudhur nga pleqëria. Më ngjan me një nga ata pleqtë e odave tona, për të cilët, edhe kur janë të rënë fare, prapëseprapë themi «ta zbukurojnë oxhakun». Më ngjan me një gjysh të mençur e të urtë, me një pleqnar ku burrat trima e me përvojë vijnë për t'iu këshilluar. Më lind një dëshirë për t'iu afruar, për ta prekur, gati për t'i rënë në gjunjë. Për gjuhën, shqipen e tij. Për shqipen tonë. Të nënës, të babës.

Shokët e tjerë gjithashtu nuk lëvizin. Duket bluajnë pak a shumë të njëjtat mendime. Po ato emocione përjeton secili.

Sjell ndër mend ç'kemi botuar për të dhe trishtohem kur kujtoj se në Fjalorin tonë Enciklopedik shkruhen vetëm disa rreshta, shkurt, ftohtë. I kushtohet më pak vend se në shumë fjalorë të huaj, si për shembull në Laroussin francez ose Roberin, paçka se ata, ndryshe nga ne, janë krejt të paanshëm, domethënë nuk kanë ndonjë interes të veçantë për këtë figurë. Vërtet ky nuk dha drejtpërdrejt për çështjen e shqiptarëve ndonjë ndihmesë kushedi, megjithëse u lidh e i mbështeti kryengritësit tanë kundër Portës së Lartë, si Mustafa Pashën, Zylyftar Podën e ndonjë tjetër. Vërtet qeverisi me dorë të hekurt. Po a mund të veprohej ndryshe në ato kushte e në atë kohë, për t'u ngritur në ato lartësi, që e bënë të luante rol vendimtar në përparimin e jetën e një populli e vendi të madh, duke hyrë si gur themeltar në historinë e tij të re? Dhe jo vetëm në historinë e një populli, por edhe të një qytetërimi të tërë.

— E falënderojmë me gjithë zemër Ahmetin dhe «zoti Safir» yni ka nderin ta ftojë në ambasadë për një vizitë shoqërore. Për një kafe dhe një uiski, — shton dikush.

— A, uiski haram, — tund kokën arabi dhe qesh.

Shakaja e tij na çliron dhe sikur na nxjerr nga ajo botë përmallimi e, pse jo, edhe krenarie.

— Mirë ardhsh, Ahmet, uiski haram, miqësia hallall, — i themi gati njëzëri, duke iu përgjigjur hokës së tij.

— Īnshallah!

Na përshëndet buzagaz, duke tundur dorën me një lëvizje nazike, gati vajzërore.

1990

PËRMBAJTJA

AJO QË MË NDJEK PAS	3
LUNDRIMTARË	36
TRI SKICA NGA AFRIKA	
Xhambo!	55
Ekuinoks	59
Trille të tjera	64
PIEDESTAT ET PRESIN	69
KARAFIL DHE TË TJERA	
Karafil	103
Korbat	114
Natë e butë jugore	124
I treti te Muhamet Aliu	133

Elezi, Mehmet

Ajo që më ndjek pas / Mehmet Elezi; Red.:

Q. Sakajeva. — T.: Naim Frashëri, 1990.

— 146 f.; 18 cm.

891.983-992

E 54

U dorëzua për shtyp dhjetor 1990

Doli nga shtypi më

Tirazhi 3000 kopje

Formati 49x78/16

Stash 2204-82

Shtypur Kombinati Poligrafik

Shtypshkronja «8 Nëntori» — Tiranë, 1990